

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për programin e studimit

Master i Shkencave në “E drejtë penale”

Kolegji Universitar “Luarasi”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Rezarta Demneri



Prof. Asoc. Dr. Skerdian Kurti



Tetor/2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Luarasi"
2	Fakulteti që e ofron	Njësia Kryesore: Fakulteti i Drejtësisë Njësia Bazë: Departamenti i së Drejtës Penale
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licensim: VKM Nr. 490, datë 23.06.2010
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër i MASH Nr. 323, datë 15.08.2013, VKA Nr. 514, datë 18.07.2013 Sipas pikës 2 të Urdhërit Nr. 323 të MASH institucioni brenda 6 muajve duhet të plotësojë rekomandimet e lëna në VKA
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "E Drejtë Penale"
6	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
13	Diplomë e përbashkët Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Numri i studentëve	82

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”, KU “Luarasi”¹

Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” i Kolegjit Universitar “Luarasi” ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe më konkretisht nga Departamenti i së Drejtës Penale.

Kolegji Universitar “Luarasi” është licencuar për ushtrimin e aktivitetit si shkollë e lartë universitare, jopublike, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 11.09.2003 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Luarasi”. Sipas këtij vendimi shkolla është e nivelit universitar, dhe ofron programe studimi në një degë të vetme – Drejtësi, me kohëzgjatje të kursit të studimit 4 vjet. Mbi bazën e këtij akti institucioni ka nisur veprimtarinë e mësimdhënies në vitin akademik 2003 – 2004.

Me Urdhër Nr. 324, datë 21.06.2010, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e ndryshimit të programit të studimit “Drejtësi” të Shkollës së Lartë Private “Luarasi”, është miratuar ndryshimi i programit të studimit në “Drejtësi” në SH.L.U.J. “Luarasi” në program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, me 180 kredite dhe me kohëzgjatje të programit 3 vite akademike. Në përfundim të studimit, sipas urdhërit, lëshohet “Diplomë e Nivelit të Parë (DNP)”, në “Drejtësi.

Me anë të Urdhërit Nr.515 datë 27.10.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e statutit të Kolegjit Universitar “Luarasi”, është miratuar statuti i Kolegjit Universitar “Luarasi”.

Hapja e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, me kohë të plotë, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike është bërë me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.490, datë 23.06.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimeve, në Shkollën e Lartë Universitare Private “Luarasi”, Tiranë”.

Për herë të parë, akreditimi i programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është bërë me Urdhërin Nr.323, datë 15.08.2013², të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për akreditimin e programeve të studimit që përfundojnë me “Master i shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” dhe në “E Drejtë Penale”, të Shkollës së Lartë Jopublike “Luarasi.

Ky program studimi është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS, ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Dr. Rezarta Demneri

Prof.Asoc. Dr. Skerdian Kurti

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 18.09.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 139/30 Prot., “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, KUL është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 30.09.2019, KUL përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 235 Prot., “Përcillen komente mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e ciklit të dytë të studimit

¹ Të dhëna të marra nga Evidenca 1, Evidenca 3 dhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.

² Sipas pikes 2 të këtij Urdhëri institucioni brenda 6 muajve duhet të plotësoje rekomandimet e lëna në VKA Nr. 514, datë 18.07.2013. ASCAL nuk ka të dhëna për plotësimin e tyre brenda 6 muajve. Në RVB e Institucionit (hartuar nga KU Luarasi, në kuadër të riakreditimit të programit të studimit), është shkruar për plotësimin e këtyre rekomandimeve. GVJ analizon plotësimin e tyre në këtë raport.

“Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale””. Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ. GVJ pasi u njoh me komentet e përcjella nga institucioni ne lidhje me raportin e GVJ, për PS “MSc në E Drejtë Penale”, vendosi të përgjigjet dhe të reflektojë/ose jo në Raport.

GVJ thekson se në lidhje me komentet e KUL ndaj Draft-RVJ:

- GVJ nuk ka “**pretendime**” përse ky kufizohet në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit e mandej në raportimin mbi **faktet e konstatuara nga evidenca dhe vizita në Institucion**.
- Përfaqësuesve të KUL i është komunikuar edhe gjatë vizitës që krahasimet me IAL-të e tjera nuk janë të mirëpritura.

Përgjigjet më të detajuara gjenden në fund të këtij Raporti.

ANALIZË PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KËSHILLI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën e kryer në Institucion, GVJ ka vlerësuar plotësimin e rekomandimeve të përcaktuara nga Vendimi n. 514, datë 18.07.2013 i Këshillit të Akreditimit³ dhe konkludon si më poshtë:

Rekomandimet e mëposhtme janë plotësuar plotësisht:

- *Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e pranimit në këtë program studimi, në përmbushje të interesave të studentëve për të mos e vazhduar organizimin e mësimit gjithmonë pasdite.*

Rezulton që krahasuar me vitin akademik 2013-2014 të akreditimit fillestar të Programit, numri i studentëve është rritur nga **28** në **49** studentë. Rekomandimi është plotësuar plotësisht paçka se Institucioni me *feedback* të studentëve nuk ka parashikuar të ndryshojë zhvillimin e mësimit nga pasdite siç është aktualisht në paradite përse studentët janë të angazhuar në marrëdhënie pune dhe për ta është më e volitshme frekuentimi i Programit pasdite.

Rekomandimet e mëposhtme janë plotësuar kryesisht:

- *Të mbahet një ekuilibër dinamik në çështjen e ndërtimit të punës së personelit akademik mbi kërkimin shkencor të studentëve.*

Studentët e Institucionit rezultojnë të jenë aktivizuar në punimin e artikujve shkencorë të botuar në Revistën e IAL-së “Mendimi” edhe pse jo detyrimisht gjatë frekuentimit të këtij Programi apo gjatë ndjekjes së studimeve në këtë Institucion. Studentët janë të detyruar të zgjedhin një nga 91 temat e caktuara paraprakisht nga personeli akademik i angazhuar në Program çka përbën kufizim të spektrit kërkimor-shkencor. Në lidhje me këtë Rekomandim institucioni ka bërë përpjekje të shumta me qëllim përmirësimin e tij.

Bazuar në Evidencën 25 parashtruar nga KUL në kuadrin e akreditimit të MSc_EDP, e drejta për aksesimin e bibliotekës elektronike Questia kishte skaduar në 2017 dhe disa tekste bazë të lëndëve të zhvilluara në Program nuk gjenden në bibliotekën e Institucionit çka nuk mundëson zhvillimin e kërkimit shkencor nga ana e studentëve apo e stafit akademik me përjashtim të eventualitetit që këta të fundit të angazhohen individualisht dhe në mënyrë autonome për gjetjen e burimeve bibliografike te nevojshme për kërkimin shkencor. Në lidhje me e-mailin e integruar nga KUL më 30 shtator bashkëlidhur komenteve të Draft-RVJ që përmbante abonimin vjetor (2018-2019) në këtë bibliotekë në adresë të Administratorit të KUL, z. KB, ekspertët kanë qëndrime të

³ Në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr.323, datë 15.08.2013, “Për akreditimin e programeve të studimit që përfundojnë me “Master i shkencave” në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” dhe në “E Drejtë Penale”, të Shkollës së Lartë Jopublike “Luarasi.

ndryshme mbi të drejtën e aksesueshmërisë nga ana e studentëve/pedagogëve të KUL në këtë *account*, sipas sa argumentuar në Përgjigjen e GVJ ndaj Komenteve të KUL (f. 5-6).

- *Të bëhen më shumë përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik efektiv*

Përsa i përket personelit akademik të **Programit** rezulton se: Numri i PAE anëtarë të Departamentit të së Drejtës Penale (DDP) të angazhuar në mësimdhënie në këtë Program në vitin akademik 2018-2019 ka rënë nga 4 në 3 krahasuar me atë të vitit akademik 2013-2014. Përveç 3 PAE të DDP, IAL-ja ka angazhuar në këtë Program edhe 2 pedagogë PAE të strukturave të tjera të IAL-së (përkatësisht nga Departamenti i së Drejtës Publike dhe nga TIK), nga të cilët njëri është ekspert i fushës në të cilën zhvillon mësim.

Numri i pedagogëve efektivë të IAL-së të angazhuar në këtë Program është rritur me 1 PAE krahasuar me 4 PAE të vitit akademik 2013-2014 por numri i PAE të Departamentit të së Drejtës Penale në fakt është ulur me 1 PAE krahasuar me vitin akademik 2013-2014.

Nëse rekomandimi është që të rritet numri i PAE që jep mësim në këtë Master, pavarësisht departamentit ku pedagogu bën pjesë, atëherë mund të konkludohet se KUL ka bërë përpjekje për të përmirësuar këtë pikë pavarësisht vështirësive të shumta që ekzistojnë për të realizuar këtë gjë."

Rekomandimi i mëposhtëm nuk është plotësuar:

- *Të përmirësohet shpërpjestimi që ekziston për raportin pedagogë të brendshëm – pedagogë të jashtëm duke siguruar në rekrutimet e personelit të pedagogëve kriterin e cilësisë, bazuar në profilin e spikatur, karrierën në fushën përkatëse, përvojën në mësimdhënie dhe punën kërkimore e botuese.*

Duke konsideruar që numri total i pedagogëve të angazhuar në Program në periudhën nga viti 2013-2014 në 2018-2019 nuk ka ndryshuar i.e. 10 pedagogë, GVJ vëren se raporti PAE/PAK nga viti akademik 2013-2014 ka ndryshuar nga 4/6 në 5/5. Nga ana tjetër, në vitin akademik 2018-2019, 1 PAK nuk ka gradën shkencore "Doktor" në fushën që zhvillon mësim dhe 1 PAK nuk ka gradën shkencore "Doktor" por gradën profesionale "Mjek" (MD) dhe Specializim Pasuniversitar (SPA) dhe mbi 50 vite eksperiencë akademike e profesionale. KUL ka bërë përpjekje për rekrutimin e personelit akademik të brendshëm dhe plotësimin e këtij rekomandimi por mbi bazën e të dhënave të vëna në dispozicion rezultoi që ky shpërpjestim nuk ka patur përmirësime të ndjeshme.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" ka filluar të zbatohet për herë të parë në vitin akademik 2013-2014 ku dhe janë regjistruar në këtë cikël studimesh 28 studentë.

Sipas nenit 3 të Statutit, KU "Luarasi" ka për mision:

- a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;*
- b) të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me Standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar objektivat e procesit të Bolonjës;*
- c) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në fushat që ushtron aktivitetin akademik;*
- ç) të ofrojë mundësi për studentët për të realizuar të mësuarit gjatë të gjithë jetës;*
- d) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;*
- dh) të integrojë*

mësimdhënien me kërkimin shkencor; e) të realizojë bashkëpunim në nivel ndërkombëtar me institucione homologe në fushën e arsimit të lartë.

Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (fq.13),

“Master i Shkencave” në “E drejtë Penale” është i fokusuar në një studim shkencor dhe të thelluar të fushave më kryesore të të drejtës penale, kriminalistikës, kriminalogjisë dhe penalogjisë, etj, por në të njëjtën kohë edhe në trajtimin e problematikave të reja juridike që janë shfaqur tashmë në fushën e të drejtës penale të para këto edhe në këndvështrimin e praktikës gjyqësore. Ky program studimi është një ndërthurje e të drejtës penale shqiptare me atë ndërkombëtare duke e trajtuar këtë në disiplina si E drejta Penale Procedurale e Krahasuar, E Drejtë Ndërkombëtare Penale, Të drejtat e njeriut dhe jurisprudenca e Strasburgut në fushën penale, etj.

Në nenin 3 të Rregullores së funksionimit të këtij program studimi përcaktohen edhe objektivat formues specifike të programit të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale”, të cilat janë:

Formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e së drejtës penale; Pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e së drejtës ndërkombëtare penale, kriminalistikës, kriminalogjisë dhe penalogjisë, të drejtës financiare penale, veprave penale në fushën e kibernetikës etj.

Në përputhje me Statutin e IAL, të Rregullores së posaçme për këtë program studimi, nisur nga informacioni i marrë gjatë vizitave në institucion por edhe nga RVB., misioni i programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është ndihma që i jepet shtetit me anë të përgatitjes së specialistëve në fushën penale.

Përsa i përket objektivave mund të përmendim këtu: përgatitjen e studentëve me njohuri të avancuara në fushën e të drejtës penale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; krijimin e kompetencave profesionale për të zhvilluar karrierën personale në fushën e së drejtës penale; pajisjen me aftësi për punë të pavarur shkencore dhe studime të mëtejshme në fushën penale; përgatitjen e studentëve me njohuri bazë të komunikimit dhe me një etikë profesionale në fushën penale; përgatitja e studentëve me qëllim që t’i shërbejnë më së miri nevojave të administratës shtetërore në përmbushjen e detyrave në fushën penale.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Shënimet e takimeve në vizitë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi L.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” (më tej Msc_EDP) është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Kjo gjë u verifikua nga Statuti, Rregullorja e funksionimit të Msc_EDP, vizita në institucion por edhe nga RVB. Bazuar në vizitat e zhvilluara në Institucion, GVJ u informua se ka një numër të konsiderueshëm studentësh që pasi kanë mbaruar një program studimi në KU “Luarasi” kanë gjetur një punë. Po kështu, në mënyrë specifike GVJ konstaton se shumica e studentëve që kanë mbaruar Msc_EDP i Shkencave në “E drejtë penale” kanë gjetur punë ose kanë bërë këtë Msc_EDP pasi u duhej për të zhvilluar aftësitë që i kërkonte vendi i punës. Për pasojë, GVJ konstaton se programet studimore të KU “Luarasi”
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

	<p>janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Kjo gjë vihet re në mënyrë specifike edhe nga analiza e programeve të lëndëve që janë pjesë e Msc_EDP, ku gërshetohen thellimi i njohurive në fushën penale kombëtare me njohuritë në fushën penale ndërkombëtare të domosdoshme për nevojat e sotme të tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit që ofron KU “Luarasi” është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Në mënyrë më specifike, Msc_EDP reflekton këtë gjë. Lëndë të tilla si Kriminologji-Penologji apo edhe Veprat penale në fushën e ekonomisë trajtojnë probleme që përputhen më së shumti me zhvillimin ekonomik të vendit, duke i trajtuar problemet edhe në aspektin ekonomik. Përmendëm këtu vetëm këto dy lëndë por pothuajse të gjitha programet e studimeve të këtij Masteri e mbajnë parasysh këtë fakt dhe përipiqen ti trajtojnë çështjet edhe në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Programi i studimit është i përshtatura dhe reflekton vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në to gjejmë trajtime të temave që kanë në përmbajtje të tyre interpretimin e normave ligjore me karakter kombëtar.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit që ofron KU “Luarasi” është në përputhje edhe me strategjinë për zhvillim të institucionit. Bazuar në Planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitin 2016-2020 janë hartuar edhe programet e studimeve. Përgatitja e programeve të studimit është në përputhje, ndër të tjera me strategjinë e zgjerimit të KU “Luarasi”, gjithmonë duke mbajtur të pacënuar cilësinë. Programi i studimit reflekton kulturën institucionale, vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”, përputhet me kriteret e përcaktuara ligjore dhe nënligjore. Përmbajtja e këtij programi studimi është ndërtuar duke respektuar dhe zbatuar kërkesat e Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Në bazë të dokumentave që na u vunë në dispozicion, KU “Luarasi”, ka hartuar dhe miratuar Planin strategjik të zhvillimit për periudhën 2016 – 2020. Në këtë plan strategjik një rëndësi të madhe i kushtohet edhe zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.</p> <p>Sipas Planit strategjik, në KU “Luarasi”, nxënia mbetet funksioni qendror dhe mësimdhënia ndaj studentëve është qëllimi kryesor i institucionit. Ky qëllim arrihet duke vlerësuar dhe mbështetur risitë</p>

	<p>në metodat e mësimdhënies dhe duke promovuar kontributet e secilit pedagog në lidhje me to në shkallë universiteti, por edhe në nivel kombëtar. KU “Luarasi” mundohet të krijojë një mjedis që promovon të mësuarin e angazhuar, aktiv dhe interaktiv, që ka si qëllim të tij final të përgatisë studentët në profesionet e tyre të ardhshme të punës, si dhe që do të dinë që t’i trajtojnë problemet sipas qasjeve kritike dhe analizuese, gjithmonë duke i shërbyer edhe dialogut konstruktiv në nivel institucioni, kombëtar, rajonal dhe global.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni e ofron këtë program studimi, Master i Shkencave në “E drejtë penale” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. 2. Programi i studimit Msc_EDP është hartuar në përputhje me Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. 3. Institucioni ka një strategji të vlefshme deri në vitin 2020 por që duhet rinovuar për më tej në lidhje me të gjitha aspektet dhe në mënyrë të veçantë me zhvillimin akademik, procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. 4. Nëpërmjet këtij programi studimi, studentët përfitojnë njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën penale, me qëllim krijimin e mundësive për punësim dhe karrierë në sektorin publik dhe atë privat. 5. Institucioni i kushton rëndësi procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke synuar përmirësimin e mundshëm të tij me qëllim që t’u ofrojë studentëve një shërbim sa më cilësor. 6. Programi i studimit Msc_EDP është i përshtatur dhe reflekton vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. 	

2. Struktura akademike e Fakultetit, Departamentit përgjegjës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Master i Shkencave” në “E drejtë Penale” është Fakulteti i Drejtësisë. Sipas nenit 8 të Statutit të KU “Luarasi”, ky fakultet organizohet në tre njësi bazë që janë:

- Departamenti i së Drejtës Private
- Departamenti i së Drejtës Publike
- Departamenti i së Drejtës Penale

Njësia Bazë përgjegjëse që ofron programin e studimit Msc_EDP është Departamenti i së Drejtës Penale. Sipas nenit 25 të Statutit, autoriteti drejtues akademik i departamentit dhe që e përfaqëson atë është Drejtuesi i Njësisë Bazë (Përgjegjësi i Departamentit).

Ndër funksionet kryesore të Përgjegjësitë Departamentit (neni 26 i Statutit):

i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimet e njësive bazë; drejton të gjithë aktivitetin mësimor dhe shkencor të njësisë bazë; siguron zbatimin e planeve dhe programeve të studimeve, të cikleve të ndryshme,

nga njësi bazë; drejton punën për hartimin e rregullores së njësisë bazë dhe i propozon drejtuesit të njësisë kryesore miratimin e saj; drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore të njësisë bazë dhe siguron zbatimin e tyre; miraton programet mësimore dhe planet kërkimore të personelit akademik të njësisë bazë; ushtron të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në statut dhe rregullore.

Sipas nenit 9 të Statutit, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore. Departamenti harton programet e studimeve dhe propozon numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të tij, sipas standardeve të cilësisë. Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurës së përcaktuar në rregullore. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse të miratuara nga Senati Akademik, si dhe mund të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit/ Departamentit të së Drejtës Penale

Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Msc_EDP është Fakulteti i Drejtësisë, me tre Njësi Bazë. Departamenti përgjegjës për këtë program studimi është **Departamenti i së Drejtës Penale**.

Në vitin akademik 2018-2019 secila prej njësive bazë ka patur në përbërje të saj të paktën 7 pedagogë efektiv, nga të cilët, të paktën 3 prej tyre, gëzojnë tituj ose grada shkencore. Konkretisht departamentet janë organizuar:

- Departamenti i së Drejtës Penale ka në përbërje të tij 7 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 1 Prof. Asoc., 2 Dr, 4 Msc; si edhe 10 pedagogë me kontratë (PAK) nga të cilët: 8 Dr, 1 SPA, 1Msc.
- Departamenti i së Drejtës Private ka në përbërje të tij 7 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 2 Prof. As., 2 Dr, 3 Msc; si edhe 8 pedagogë me kontratë (PAK) nga të cilët: 1 Prof.Dr., 1 Doc, 3 Dr, 3 Msc.
- Departamenti i së Drejtës Publike ka në përbërje të tij 7 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 3 Dr dhe 4 Msc; si edhe 7 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët: 1 Prof. Dr., 1 Prof.As., 3Dr, 2Msc (1 në proces doktrate)

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Në Programin MSc_EDP janë angazhuar:

- 3 PAE dhe 2 PAK personel i Departamentit Penal
- 2 PAE që i përkasin strukturave të tjera të KUL dhe 3 PAK personel i Departamentit të së Drejtës Publike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik që punon pranëKU "Luarasi", dhe më konkretisht në Departamentin e së Drejtës Penale të Fakultetit të Drejtësisë është organizuar që në
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	

<p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>mënyrë të vazhdueshme të garantojë realizimin e objektivave të programit të studimit Msc_EDP.</p> <p>Njësitë përbërëse organizative të KU “Luarasi” përfshijnë njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë ndihmëse administrative.</p> <p>Njësi kryesore janë: Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit.</p> <p>Njësi bazë janë departamentet (3 të tillë për çdo Fakultet) me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar.</p> <p>Njësi ndihmëse/administrative të cilat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e KU “Luarasi”, me qëllim përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit.</p> <p>Në departament përfshihet gjithë personeli akademik efektiv dhe me kontratë, sipas disiplinave përkatëse. Secili departament është i përbërë nga të paktën 7 pedagogë efektivë, ndër të cilët të paktën 3 janë me grada shkencor dhe/ose tituj akademik.</p>
--	--

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik nëKU “Luarasi” dhe bazuar në Statut, Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë, Rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytëMsc_EDP, u konstatua se Fakulteti i Drejtësisë dhe Departamenti i së Drejtës Penale janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kanë për realizimin e këtij programi studimi gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së tij.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik u parashtuan edhe mënyrat e procesit të rekrutimit të stafit akademik, të cilat bëhen në respekt të Ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së Brendshme të KU “Luarasi”.</p> <p>Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për vendet e lira të punës, propozohen nga përgjegjësi i departamentit përkatës, pas konsultimit me anëtarët e departamentit</p> <p>Në përzgjedhjen e stafit akademik KU “Luarasi” i jep përparësi rekrutimit të kandidatëve të kualifikuar në universitete të njohura ndërkombëtare, fakt që dëshmohet edhe nga përbërja aktuale e personelit.</p> <p>KU “Luarasi” ka të punësuar edhe personel akademik me kontratë, në funksion të nevojave të programeve të studimit që ai ofron.</p> <p>Institucioni mundohet që të përzgjedhë figura të shquara të fushës së drejtësisë.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. KU “Luarasi” është i organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” .
2. KU “Luarasi” ka 3 (tre) njësi kryesore të cilat janë të përbëra nga 3 (tre) njësi bazë.
3. Fakulteti i Drejtësisë është i përbërë nga Departamenti i së Drejtës Penale, Departamenti i së Drejtës

Publike dhe Departamenti i së Drejtës Private.

4. Departamenti i së Drejtës Penale ka në përbërje të tij 7 pedagogë (PAE) nga të cilët, të paktën 3 kanë gradën shkencore “Doktor”.
5. Fakulteti i Drejtësisë dhe Departamenti i së Drejtës Penale janë të përkushtuar për realizimin e Programit të Studimit të ciklit të dytë Msc_EDP.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Për realizimin e këtij Programi studimi MSc_EDP, Institucioni (KUL) ka angazhuar Personel Akademik Efektiv (PAE) si dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) të Departamentit të së Drejtës Penale, të së Drejtës Publike si edhe të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit të Institucionit (TIK).

Stafi akademik PAE dhe PAK ka gradën shkencore në fushën që jep mësim me përjashtim të dy PAE nalizuar konkretisht më poshtë. Në disa raste, PAK janë edhe titullar lënde të pambështetur nga ndonjë PAE.

Lëndët e zhvilluara në Program i përkasin të Drejtës Publike dhe të Drejtës Penale dhe nuk vërehet të ketë mbivendosje me Programin e Studimit të Ciklit të I-rë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre**

GVJ gjatë vizitës u njoh me stafin e Programit dhe nga vizita dhe dokumentacioni i parashtruar (Shih Aneks Tab. 3) rezultoi se që nga viti akademik 2013-2014 është angazhuar personel akademik si më poshtë:

1. **Për vitin akademik 2013-2014:** janë angazhuar **4 PAE**, nga të cilët 2 “Prof.Asoc”, 2 “Dr” dhe **6 PAK** nga të cilët 2 “Prof.Dr”, 1 “Prof.Asoc” dhe 3 “Dr” dhe 1 gradën profesionale “Mjek” (MD) dhe kurs specializimi (SPA). Raporti PAE/PAK ishte 1:1,5.
2. **Për vitin akademik 2014-2015:** janë angazhuar **4 PAE** nga të cilët 2 “Prof.Asoc.” 2 “Dr” dhe **5 PAK** nga të cilët 1 “Prof.”, 1 “Prof. Asoc.”, 3 “Dr” dhe 1 gradën profesionale “Mjek” dhe SPA. Raporti PAE/PAK ishte 1:1,25.
3. **Për vitin akademik 2015-2016:** janë angazhuar **4 PAE** nga të cilët 1 “Prof. Asoc”, 3 “Dr” dhe **4 PAK** nga të cilët 1 “Prof.”, 3 “Dr”. Raporti PAE/PAK ishte 1:1.
4. **Për vitet akademike 2016-2017, 2017-2018:** janë angazhuar të njëjtët pedagogë me përbërje si vijon: **4 PAE** nga të cilët 1 “Prof.As”, 3 “Dr”, dhe **4 PAK**, nga të cilët 1 “Prof.Dr”, 2 “Dr”, 1 SPA (Mjek). Raporti PAE/PAK ishte 1:1.
5. **Për vitin akademik 2018-2019:** janë angazhuar: **5 PAE** nga të cilët 1 “Prof.As”, 4 “Dr”, dhe **5 PAK**, nga të cilët 1 “Prof.Dr”, 3 “Dr”, 1 SPA (Mjek). Raporti PAE/PAK është 1:1.

Për këtë Program studimi rezulton se:

- **5 PAE:** 3 PAE të Departamentit të së Drejtës Penale, 1 PAE i Departamentit të së Drejtës Publike, 1 PAE nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit (TIK)
- **5 PAK.** Nga këta, 3 janë PAK të Departamentit të së Drejtës Publike.

Ngarkesa mësimore e stafit akademik. Raportet midis tyre

Rezulton se në RVB ishin numëruar të gjithë lëndët me zgjedhje ndërkohë që për shkak të numrit të ulët të studentëve Institucioni i komunikoi GVJ gjatë vizitës se në fakt aktivizohej vetëm 1 lëndë me zgjedhje/vit. Raporti PAE/PAK i ngarkesës mësimore **në auditor** është 60%:40%. Për vitet e mëparshme, Institucioni nuk ka parashtruar të dhëna. **GVJ rekomandon që diploma të mbulohet nga PAE që nga viti i ardhshëm akademik.**

Një pedagog PAK tejkalon ngarkesën maksimale të lejuar prej 120 orësh/vit me 90 orë në auditor. Neni 18 i Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë përcakton që “*Ngarkesa e plotë për personelin akademik përcaktohet me udhëzim të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.*”. GVJ rekomandon të rishikohet shpërndarja e ngarkesës.

Analizë për CV e stafit akademik

1. Nga vizita GVJ-ja arriti në përfundimin se personeli akademik kishte kontrata të rregullta me disa mangësi si më poshtë:
 - i. 1 CV e PAE kishte nevojë për përditësim të punës shkencore nga akreditimi i 2013.
 - ii. Mungonte CV-ja e 1 PAK ndër evidencat e dorëzuara para vizitës në Institucion dhe nuk është integruar edhe pasi iu kërkua nga GVJ. Në vizitë u konsultua dosja e këtij PAK dhe u vërejt se i mungonte diploma e gradës shkencore “Doktor” fituar më 2018.
 - iii. Mungojnë vitet tek puna shkencore e disa PAE në Aneks Tab. 21. Po këtu, disa zëra punimesh shkencore janë duplikate (shënuar me të kuq nga GVJ).
2. PAE dhe PAK i angazhuar në mësimdhënie përgjithësisht është i kualifikuar për lëndët që zhvillon me të paktën gradë shkencore në profilin shkencor përkatës. Personeli akademik i angazhuar në këtë Program ka qenë i qëndrueshëm në tre vitet e fundit akademike dhe përgjithësisht rezulton të jetë i përshtatshëm për Programin me 2 rezerva:
 - a) Një PAK i angazhuar mbi bazë kontrate në Departamentin e së Drejtës Publike ka gradën shkencore “Doktor” në fushën e së drejtës civile të fituar në vitin 2018. Lënda e zhvilluar në Programin MSc “E Drejtë Penale” në të cilën është angazhuar ky PAK i përket Departamentit të së Drejtës Publike. GVJ ka rezerva mbi përshtatshmërinë e këtij PAK për të zhvilluar mësimdhënie në një degë të disiplinës shkencore të ndryshme nga ajo në të cilën kategorizohen studimet doktorale që ka përfunduar duke konsideruar edhe mungesën e eksperiencës profesionale post-doktoraturë me kohëzgjatje rreth 1 vit.
 - b) Një PAK mban titullin “Doktor” në përfundim të studimeve universitare në mjekësi dhe duhet cilësuar si MSc/MD i.e. akronim i *medical doctor* jo “Doktor” për të shmangur keqkuptime që do çonin në cilësimin e tij sikur të kishte gradë shkencore. Në bazë të legjislacionit në fuqi, cikli i dytë i studimeve kërkon angazhimin e personelit akademik me të paktën gradën shkencore “Doktor”. Lënda e zhvilluar nga ky PAK i përket disiplinës shkencore mjekësore në të cilën ky PAK në fakt zotëron specializime afatgjata pasuniversitare e mandej eksperiencë profesionale dhe akademike në mësimdhënie që tejkalon 50 vitet. Përsa më sipër ky PAK mund të cilësohet si “ekspert”. Sipas Kreut VII, pika 2 b) të Udhëzimit MASR n. 31, datë 29.12.2017 “eksperti” është një kategori që parashikohet të jetë e përshtatshme për mësimdhënie në ciklin e 3-të të studimeve “Master Ekzekutiv” përpos kategorisë “Profesor” që si rregull angazhohet në ciklin e 3-të të studimeve. Kjo për shkak se ligjvënësi i jepet prioritet me disa kushte (deri në masën 30% të stafit të atij programi konkret) ekspertizës profesionale në atë disiplinë. GVJ vëren se për këtë PAK, kriteri i gradës shkencore nuk është përmbushur por shtrun për diskutim nëse mund të interpretohet në

mënyrë të zgjeruar qasja e Udhëzimit MASR n. 31/2017 për “Masterin Ekzekutiv” për një cikël më të ulët siç është ai i Masterit të Shkencave.

3. PAE-të e Programit MSc “E drejtë penale” për vitin akademik 2018-2019 është angazhuar në 7 lëndë kurse PAK në 5 lëndë. Për vitet akademike pararendëse duke filluar nga viti akademik 2013-2014 nuk janë vënë në dispozicion të dhëna se cili pedagog zhvillonte cilën lëndë

Koordinatori/ët e programit të studimit (Shih Tab. 2 në Aneks)

Koordinatori i Programit është Dr. Lorenc Stojani (Përgjegjës i Departamentit të së Drejtës Penale)

Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave krijuar më 2015 - Dr. Dorina Gjipali (Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike)

Të dhënat sipas seksit

Institucioni nuk ka vënë në dispozicion tabela për çdo vit akademik raportin ndërmjet gjinive. Në analizë të Aneks-Tab. 3 për vitin akademik 2018-2019, GVJ konkludoi se në 10 pedagogë të angazhuar në Program, i përkasin gjinisë femërore 2 persona të cilët janë PAE me gradën shkencore “Doktor”. Nga kjo GVJ konkludon se përfaqësimi gjinor me jo më pak se 30% për secilën gjini nuk është respektuar **në nivel njësie bazë** në Departamentin Penal por se **në nivel njësie kryesore (FD), ky raport është respektuar në masën 62%:38%**, sipas sa përcaktuar nga Ligji nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

Përsa i përket raportit ndërmjet gjinive: Nga 5 PAE, 2 janë femra nga ku vetëm njëra është e Departamentit të së Drejtës Penale. Nga 5 PAK të gjithë janë meshkuj. Raporti i pedagogëve femra/meshkuj në Program është 1:5.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Institucioni nuk ka parashtruar tabela për brezat e moshave të stafëve për secilin vit akademik. Personeli akademik në Program për vitin akademik 2018-2019 sipas brezave të moshës është pasqyruar në Tab. 5 të Aneksit.

Institucioni raporton për këtë Program studimi se: 1 PAE dhe 1 PAK t’i përkasin kategorisë “Profesor” në grupmoshën 56-65 vjeç; 1 PAK në grupmoshën 78 vjeç; 2 PAE dhe 2 PAK në grupmoshën 36-45 vjeç kanë gradën shkencore “Doktor” dhe 1 PAK ka gradën “Doktor” në grupmoshën 56-65 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

GVJ kërkoi dhe aksesoi dokumentacionin e stafit akademik efektiv dhe atij të ftuar nga ku rezultoi që të gjithë janë të pajisur me kontratë të rregullt në të cilën janë përcaktuar detyrat dhe të drejtat.

GVJ vërejtë se në disa raste kontrata e punës dhe Aneksi përkatës i saj cilësonte se në cilin Departament dhe Program studimi do të angazhohej pedagogu i ftuar por nga ana tjetër ky i fundit rezultonte të ishte i angazhuar në mësimdhënien e lëndëve të zhvilluara në programe studimi të Departamenteve të tjera përkundrejt atij të cilësuar në kontratën e punës.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës akademik është në dispozicion të gjithë IAL-së. Për vitin akademik 2018-2019, numri i stafit ndihmës akademik është 13 (Shih Aneks Tab. 1). Personeli ndihmës-akademik asiston personelin akademik në gjithë veprimtarinë e tij mësimore gjatë realizimit të planit mësimor të programit të studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës-akademik rezulton të jetë i mjaftueshëm në numër në funksion të realizimit të objektivave të Institucionit.</p> <p>Personeli njihet me detyrat dhe objektivat profesionale që duhen realizuar dhe përditësohet mbi këto të fundit nga NjBSC që organizon në mënyrë periodike (2 herë në vit) pyetësorë adresuar studentëve për vlerësimin e pedagogut si edhe vlerëson duke vëzhguar dretpërdrejtë pedagogët. NjSBC vepron mbi bazën e plani të veprimtarisë.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Statuti i Institucionit dhe Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë dhe ajo e Programit të studimit janë hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 80/2015 sipas së cilës është Departamenti organi që nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Neni 26 pika b) e Statutit dhe neni 8 i Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë duhen rishikuar për sa ia akordojnë përgjegjësit të njësisë bazë kompetencat që në fakt Ligji nr. 80/2015 ia ka caktuar njësisë bazë si organ kolegjal, jo drejtuesit të kësaj të fundit.</p> <p>Gjatë vizitës, GVJ-së pyeti nëse në mbledhjet e Departamentit mbaheshin <i>minutes</i> apo nëse procesverbali konsultohej e firmosej nga stafi akademik pjesëmarrës pasi ishte zbardhur për të siguruar transparencë meqenëse ndodhemi përpara vendimarrjes kolegjiale. GVJ-së iu dha përgjigje negative për të dyja pyetjet e parashtruara.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik bëhet mbi bazë konkurrimi bazuar në kriteret ligjore dhe kriteret shtesë të vendosura sipas nevojave të Institucionit. Ngarkesa mësimore është parashikuar nga neni 18 i Rregullores së FD të jetë ajo e caktuar me Udhëzim nga MASR. Ky parashikim zbatohet edhe për ngarkesën mësimore në auditor të PAE dhe PAK.</p> <p>GVJ vëren së një PAK tejkalon normën mësimore në auditor në masën 75%.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p>	<p>Statuti i KUL përcakton kriteret dhe procedurat për punësimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjeshme. Mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe vizitës në Institucion, rekrutimi është transparent dhe vjen si rezultat i vendimarrjes së Komisionit <i>ad hoc</i> të ngritur.</p> <p>Për këtë Program studimi për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar në total 5 PAE nga të cilët 3 janë të Departamentit të së Drejtës Penale dhe 2 janë të strukturave të tjera të</p>

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

Institucionit. Janë angazhuar gjithashtu edhe 5 PAK nga të cilët 2 janë të Departamentit të së Drejtës Penale dhe 3 janë të Departamentit të së Drejtës Publike.

Nëse PAE-të mbulojnë tërësisht ngarkesën e parashikuar për diplomën/provimin përfundimtar atëherë përmbushin kriterin që së paku **70% e ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditoritë** jetë e mbuluar nga PAE. Nëse u caktohet ngarkesë për diplomën/provimin përfundimtar pedagogëve PAK siç rezulton nga Tab. 15, atëherë ky kriter nuk përmbushet.

Për vitet paraardhëse institucioni nuk ka vendosur të dhëna

Vlerësimi i performancës së personelit akademik kryhet nëpërmjet kontrolleve të paralajmëruara të veprimtarisë së mësimdhënies nga ana e një komisioni të brendshëm si edhe nga anketimet periodike (2 herë në vit) të drejtuara studentëve e të përpiluara nga NjBSC. Pjesmarrja e studentëve në përpilimin e këtyre të fundit raportohet nga NjBSC gjatë vizitës në Institucion se ka qenë e ulët.

NjBSC jep sygjerrime për përmirësimin e punës për rritjen dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë në veprimtaritë e ndryshme të IAL-së dhe Dekanati monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të njësisë kryesore dhe ndjek në vazhdimësi aktivitetin akademik të njësisë kryesore dhe bën propozimet përkatëse për ndryshimet e nevojshme, në funksion të përmbushjes të standardeve të cilësisë

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Përgjegjësi i programit të studimit Msc_EDP është Përgjegjësi i Departamentit që mbulon këtë program studimi dhe ka gradën shkencore “Doktor” sipas Nenit 45 pika 3 të Ligjit nr. 80/2015 në po të njëjtën fushë të së drejtës dhe është pedagog efektiv në këtë Departament.

Titullarët e lëndëve të programit të studimit Msc_EDP gëzojnë të gjithë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Përjashtim bën një lëndë plotësuese ku titullari-PAK ka kualifikimin “Mjek” dhe specializim pasuniversitar afatgjatë (SPA) dhe eksperiencë mbi 50 vjeçare profesionale e akademike në atë fushë.

1 PAK/jotitullar ka gradën shkencore “Doktor” në një tjetër degë të së drejtës nga ajo së cilës i përket lënda që zhvillon.

Drejtesit e njësisë të IAL-së janë të punësuar me kohë të plotë.

Institucioni siguron personelin e mjaftueshëm akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale, në bazë të fushës së interesit që ka studenti. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private për realizimin e praktikave të studentëve të cilët kanë autonomi në përzgjedhjen e institucionit ku duan të zhvillojnë praktikën. Për këtë Program parashikohet që praktika profesionale të mbikëqyret nga 2 PAE (Aneks Tab. 12 dhe Tab. 15). Për vitin

	akademik 2018-2019 numri i studentëve është 49. Bazuar në Udhëzimin MASR n. 29/2018 (i ndryshuar), çdo grup praktike nuk duhet të përbëhet nga më shumë se 20 studentë ndaj ky kriter nuk vlerësohet se është plotësuar plotësisht.
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatitin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Sipas sa pasqyruar në RVB (f. 40) pedagogu udhëheqës i punës kërkimore së studentit është njohës i fushës dhe zotëron të paktën gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe nuk udhëheq më shumë se 10 studentë njëkohësisht.</p> <p>Nga vizita dhe nga takimi me studentët rezultoi se studentët përzgjedhin një nga 91 temat e përcaktuara paraprakisht në listë nga pedagogët e angazhuar në mësimdhënie në Program. Nëse pedagogu nuk pranon të marrë nën udhëheqje studentin që ka përzgjedhur temën përkatëse të listuar prej pedagogut, studentit i caktohet një pedagog tjetër udhëheqës. I nga studentët prezent gjatë vizitës në Institucion vlerësoi se kjo procedurë ishte kufizuese për të përsa do të dëshironte të ishte i lirë në përzgjedhjen e temës. Studentët e tjerë nuk shprehën opinion mbi këtë praktikë të zbatuar nga Institucioni. GVJ vëren se pedagogët mund të përcaktojnë fushën e temave por jo strikt temën-objekt kërkimi.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit që drejtojnë punën kërkimore të studentëve të Msc_EDP, kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe zhvillojnë veprimtari kërkimore në fushën e interesit kërkimor-shkencor me <i>output</i>-e sipas sa pasqyruar në Aneks Tab. 22.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollorë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi gëzon mbështjetjen nga veprimtaria e personelit ndihmës-sakademik të kualifikuar. Nisur nga specifika e programit, Institucioni ka në dispozicion edhe një Laborator të Kriministikës dhe një Laborator të Informatikës. Këto dy struktura janë aset pozitiv për mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore brenda dhe jashtë auditorit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të matur me orë mësimore. Neni 17 i Rregullores së FD dhe neni 7 i Kontratës-tip të punës përcaktojnë detyrimin për pedagogun që të botojë të paktën 2 herë në vit në Revistën “Mendimi” të Institucionit në kuadrin e veprimtarive që synojnë promovimin</p>

tyre, vlerësohen me orë mësimore.

akademik sipas kritereve të përcaktuara nga MASR. Nga ana tjetër, Revista “Mendimi” ende nuk është miratuar nga MASR si revistë kombëtare me karakter shkencor.

GVJ vëren se puna kërkimore nuk mund të cilësohet pjesë e ngarkesës mësimore siç përcakton neni 17 i Rregullores së FD përsa kërkimi shkencor dhe mësimdhënia janë 2 veprimtari të veçanta nga 4 veprimtaritë që kryen personeli akademik sipas Udhëzimit MASR n. 29/2018 8 (i ndryshuar)

Nga vizita rezulton që në Program janë angazhuar 3 PAE të Departamentit të së Drejtës Penale dhe 2 PAE nga struktura të tjera të IAL-së dhe 5 PAK nga të cilët 3 janë PAK të Departamentit të së Drejtës Publike. Bazuar mbi këto të dhëna, rezulton që personeli akademik i brendshëm mbulon 74% të ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit përkundrejt 26% të PAK. Bazuar në Aneks-Tab. 12, PAE ka realizuar 510 orë në auditor dhe PAK 345 orë në auditor. Diploma/Provimi është llogaritur si “orë brenda auditorit” ekuivalente me “leksionin” në Aneks-Tab. 17 ndërkohë që VKM n. 41/2018 dhe Udhëzimi MASH n. 15/2008 përcaktojnë Diplomën/Provimin si “veprimtari jashtë auditorit”.

Duke iu referuar Tab. 12 dhe Tab. 15 të Aneksit mbi mësimdhënien në auditor të 12 lëndëve në total vërehet se shpërndarja “1 pedagog - 1 lëndë” zbatohet për 8 lëndë kurse ajo “2 pedagogë - 1 lëndë” zbatohet për 4 lëndë.

3 lëndë kanë për titullar të vetëm një PAK i cili nuk mbështetet nga një PAE në mësimdhënien e lëndës.

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Nga takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore rezulton që dosjet e PAE dhe PAK ishin të plota duke përmblajtur ndër të tjera CV-në, çertifikata kualifikimi dhe diploma të titujve e gradave shkencore, librezë shëndetësore dhe librezë pune, dëshmi penaliteti dhe fotokopje të kartës së identitetit. IAL-ja disponon listën e plotë të personelit akademik.

Institucioni rezulton të publikojë rregullisht kriteret për rekrutimin e stafit akademik dhe procesi i përzgjedhjes është transparent.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. GVJ vëren se personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe ai administrativ i Institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e Programit të studimit dhe strategjinë për zhvillim të institucionit.
2. GVJ vlerëson se rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përgjithësisht, personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve. GVJ vërejtë gjatë vizitës në Institucion një mospërputhje me Ligjin n. 80/2015 të dy dispozitave të akteve të IAL-së, përkatësisht Neni 26 pika b) e Statutit dhe Neni 8 i Rregullores së FD në pjesën kur këto i akordojnë përgjegjësit të njësisë bazë kompetenca që Ligji n. 80/2015 ia cakton njësisë bazë si organ kolegjal. Dispozitat e tjera të Statutit dhe të Rregullores janë formuluar në mënyrë korrekte duke i

atribuar njësisë bazë kompetenca të caktuara siç parashikon Ligji n. 80/2015. Gjithashtu, GVJ-ja rekomandoi që procesverbali i zbardhur i mbledhjeve të Departamentit t'u vihej në dispozicion stafit akademik efektiv pjesëmarrës për të siguruar transparencë në vendimarrje meqenëse Ligji i njeht kompetenca të rëndësishme njësisë bazë si organ kolegjal. GVJ vlerëson se ekziston rreziku latent i konfliktit mes dispozitave të ndryshme të Statutit dhe Rregullores së FD si dhe mes këtyre të fundit dhe atyre të Ligjit n. 80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. GVJ vëren se Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.
4. GVJ vëren se përgjithësisht personeli akademik mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë të drejtat dhe detyrimet me përjashtim të rezervave të parashtruara mbi procedurat e vendimarrjes që i janë caktuar me ligj njësisë bazë si organ kolegjal dhe jo drejtuesit të kësaj të fundit.
5. Studentët përzgjedhin temat nga një listë e përpiluar paraprakisht nga pedagogët e Programit nëpërmjet një mekanizmi zgjedhjesh mes alternativave teme/udhëheqës që siguron që çdo student të ketë për udhëheqës një pedagog njohës të fushës studimore-kërkimore. Çdo pedagog nuk udhëheq më shumë se 10 studentë. GVJ vlerëson se Departamenti mund të caktojë fushat e temave të diplomës por jo objektin specifiktë secilës.
6. Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij në Programin “E drejtë penale”.
7. Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi me përjashtim të një PAK që tejkalon me 75% normën e lejuar prej 120 orësh në auditor (përcaktuar nga Udhëzimi MASR n. 29/2018 (i ndryshuar).

Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. Sipas RVB dhe Evidencave të parashtruara nga GVB, udhëheqja e diplomës është përlllogaritur si orë leksioni (brenda auditorit) çka sjell deformim në rezultatet e përlllogaritjeve të ndryshme të lidhura me ngarkesën dhe veprimtaritë e stafit akademik. Udhëzimi MASH n. 15/2018 dhe VKM n. 41/2018 përcaktojnë se veprimtaritë që lidhen me diplomën apo praktikën profesionale/mësimore në ente publike apo private të ndryshme nga auditori i IAL-së janë “veprimtari jashtë auditorit”.
8. Nga vizita në Institucion rezultoi se KUL dispononte një bazë të dhënash për personelin e Programit.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

KU “Luarasi” ofron një infrastrukturë të kënaqshme për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha ciklet e studimit. Mjediset e brendshme dhe të jashtme janë të një cilësie të mirë dhe plotësojnë kërkesat e studentëve për mësim studim dhe punë të pavarur. Këto mjediset dhe të gjitha fasilitetet infrastrukture/ logjistike janë në shërbim, për të tre njësitë kryesore të KU “Luarasi”: Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Ekonomik dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit.

KU “Luarasi” e ushtron aktivitetin e tij mësimdhënës në adresën: Rr. “Elbasanit”, Nd.59, H.1, Tiranë. Godina është përshtatur plotësisht për institucion të arsimit të lartë dhe plotëson të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, sipas përcaktimeve të VKM nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e

institucionineve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre” dhe Udhëzimit të MASR nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë”.

KU “Luarasi” ofron logjistikë moderne në ndihmë të zhvillimit të mësimi e cila është në shërbim të nevojave të stafit akademiko – administrativ dhe studentëve. Qoftë nga biseda që GVJ zhvilloi me stafin akademik, qoftë nga biseda që zhvilluam me studentët morëm konfirmimin e tyre për lehtësirat që kanë për të patur akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, lehtësojnë komunikimin pedagog – student, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit. Nga vëzhgimi në ambientet e institucionit vumë re se këto ambiente ishin të pajisura me kompiutera me akses në internet apo videoprojektorë.

Për mbështetjen e programit akademik dhe të veprimtarisë shkencore të institucionit një vend të veçantë zë edhe biblioteka e cila është në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore që kryhet në institucion. Biblioteka siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës dhe administrativ, si dhe për persona të tjerë të interesuar. Ajo që duhet përmirësuar është shtimi i ambienteve bibliotekare edhe numri i librave që studentët mund të gjejnë gjatë kohës së studimit në të.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Fakultetin/ përgjegjës për programin e studimit (Tabela 6, në Aneks)

Sipërfaqja totale e objektit (godinë + oborr) është 6.609m². Nga kjo sipërfaqe 2822 m² është sipërfaqe funksionale dhe përbëhet nga godina me 5 kate, ku sipërfaqja e katit përdhe është 975 m² dhe sipërfaqja e katër kateve të tjera 703 m² për çdo kat.

Mjediset për stafin (Tabela 7, në Aneks)

Në mjediset e KU “Luarasi” kishte: 2 Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin me sipërfaqe totale 56 m²; 1 Zyrë për sekretarinë mësimore me sipërfaqe 20 m²; 1 Zyrë për departamentet/qëndrat kërkimore me sipërfaqe 56 m²; 4 Zyra për personelin akademik me sipërfaqe totale 56 m²; 1 Zyrë për financën me sipërfaqe 19 m²; 1 Zyrë për Njësinë SBC me sipërfaqe 19 m²; 1 Sallë për mbledhje me sipërfaqe 55 m²; 1 Mjedis për stafin e shërbimit me sipërfaqe 13 m²; 2 Nyje hidrosanitare për personelin akademik me sipërfaqe 56 m².

Gjithsej janë 350 m²/ për 30 persona dhe për 1 person janë 11.6 m².

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	KU “Luarasi” ka një vendndodhje të përhershme ku ndodhen mjedisi administrativ qendror dhe mjedisi për zhvillimin e procesit mësimor. KU “Luarasi” e ushtron aktivitetin e tij mësimdhënës në adresën: Rr. “Elbasanit”, Nd.59, H.1, Tiranë.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	KU “Luarasi” ka nënshkruar me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës një kontratë qiraje, për një periudhë 20-vjeçare, mbi objektin ish-Konvikti i Shkollës së Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, Rruga e Elbasanit, Tiranë, me sipërfaqe prej 6.609 m ² e cila është vënë në funksion të procesit mësimor prej Korrikut 2016.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Institucioni e zhvillon programin e studimit në një godinë ku sigurohet menaxhimi efikas dhe kontrolli i vazhdueshëm, me ambiente me mjete didaktike dhe informative me qëllim arritjen e
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për	

<p>realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>standarteve të programit të studimit që ofron.</p> <p>Në funksion të praktikave mësimore apo profesionale KU "Luarasi" ka realizuar, ndër vite, disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të rëndësishme shtetërore dhe sipërmarrje private, ku studentët kanë zhvilluar praktika profesionale, stazhe apo internshipe.</p> <p>Orë të praktikës mësimore apo laboratorike zhvillohen në laboratorin e kriminalistikës dhe atë të informatikës.</p> <p>Në Institucion është ngritur edhe Klinika Ligjore e cila ka për qëllim të ofrojë ndihmë juridike falas për personat në pamundësi ekonomike për të përballuar përfaqësimin ligjor nga avokati si dhe të përfshijë studentët e Fakultetit të Drejtësisë në praktikat e Klinikës.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mesimore për lëndët/modulet. Për ato që nuk kanë tekste sigurohen leksione të shkruara të disponueshme nga studentët. Nga biseda e zhvilluar me studentët ata pohuan se tekstet mësimore që ata përdorin i gjejnë edhe në bibliotekën e Institucionit.</p> <p>Në bibliotekë ka literaturë ndihmëse e krijuar mbi bazën e blerjeve të institucionit dhe donacioneve të përfituara ndër vite. Biblioteka është në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore që kryhet në institucion.</p> <p>Biblioteka disponon publikime periodike që i përkasin fushave të programeve të studimit. Për vitin akademik 2014 - 2015 u siguroi aksesimi i përkohshëm në bibliotekën elektronike EBSCO i cili ka kaluar në abonim të përhershëm, duke nisur nga viti akademik 2015 – 2016. Evidenca 25 përcaktonte aksesin në Bibliotekën Questia deri në Janar të vitit 2017 (për këtë çështje, referohu në përgjigjen e GVJ, pas komenteve të KUL)</p> <p>Biblioteka përditësohet sipas planifikimit të përgjegjësve të departamenteve, me qëllim mbështetjen e programit të studimit, të veprimtarisë kërkimore shkencore dhe për përgatitjen e tezës nga studentët. Institucioni shpenzon fonde të planifikuara për blerjen e teksteve mësimore dhe literaturës ndihmëse, për çdo program studimi dhe në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>Në Bibliotekë u shërbehet studentëve dhe personelit nga dita e hënë deri ditën e premte sipas orarit të përcaktuar 8:30 deri 14:00 dhe nga ora 15:30 deri 19:00. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj.</p> <p>Çdo student dhe pedagog i interesuar për të përdorur fondin e Bibliotekës së KU "Luarasi", pajiset me kartelën personale të regjistrimit.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të</p>	<p>Institucioni ka investuar dhe synon të investojë për sigurimin e kushteve optimale infrastrukturore dhe mjetet didaktike bashkëkohore për të mundësuar realizimin e mësimdhënies më një</p>

teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

cilësi të lartë.

KU "Luarasi" ushtron aktivitetin akademik në një godinë të ndërtuar me materiale cilësore bashkëkohore, që plotëson të gjitha kushtet teknike dhe ato higjieno - sanitare për ushtrimin e aktivitetit. Mjediset e zhvillimit të mësimin janë të pajisura me videoprojektorë, kompjutera dhe mjete të tjera të përshtatshme për mësim dhënie dhe në përputhje me qëllimin e programit të studimit.

Institucioni, për shkak të profileve të programeve të studimit që ofron, ka në dispozicion 2 laboratorë: Laboratorin e kriminalistikës dhe laboratorin e informatikës.

Laboratori i Informatikës është i pajisur me kompjutera apo laptope, server, printera-fotokopje/skaner, si dhe projektor.

Laboratori i Kriminalistikës është në shërbim të studentëve me njohuri të plota lidhur me kërkimin, fiksimin, paketimin, administrimin dhe ruajtjen e provave në vendin e ngjarjes. Laboratori i Kriminalistikës ka në përbërje pajisje specifike si: valixhe hetimore, pajisje për zbulimin dhe marrjen e gjurmëve në vendin e ngjarjes, pajisje për marrjen e gjurmëve të duarve të personave me precedent kriminal, lupë zmadhimi me ndriçim për ekzaminimin e dokumenteve, video-projektor me cd/dvd me përmbajtje fotosh, skicash dhe dokumentarësh, modelarë të bardhë aktesh proceduriale për plotësimin e dosjes penale që shërbejnë për plotësimin e dosjes së praktikës profesionale të studentit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Ambientet në të cilat zhvillohet aktiviteti akademik i KU "Luarasi" janë cilësore, të pajisura me infrastrukturë të përshtatshme, që përfshin pajisje elektronike dhe teknologjike, për realizimin e veprimtarisë mësimdhënëse dhe shkencore.
2. Godina është organizuar për institucion të arsimit të lartë dhe plotëson të gjitha kriteret teknike si edhe normativat e sipërfaqes së shfrytëzueshme, sipas përcaktimeve ligjore.

Rekomandim

1. Biblioteka ka nevojë për zgjerim më të madh duke rritur fondin e titujve në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Mbi bazën e takimeve që patëm gjatë vizitës në institucion arritëm të kuptojmë se pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit vijnë nga tarifat e studimit që paguhen nga studentët. Për sa i përket kapaciteteve menaxhuese, "Panorama Group", pjesë e së cilës është edhe KU "Luarasi", dhe Zyra e Financës, në bashkëpunim me njëra-tjetrën, bashkërendojnë çështjet financiare dhe menaxhuese.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi në 6 vitet e fundit (në përqindje):

Pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit vijnë nga tarifat e studimit që paguhen nga studentët dhe vetëm një pjesë e vogël vijnë nga pagesat për shërbimet administrative:

- viti 2013 99.98% tarifë studimi dhe 0.02% te ardhura nga veprimtaria;
- viti 2014 99.20% tarifë studimi dhe 0.08% te ardhura nga veprimtaria;
- viti 2015 99.46% tarifë studimi dhe 0.54% te ardhura nga veprimtaria;
- viti 2016 99.92% tarifë studimi dhe 0.08% te ardhura nga veprimtaria;
- viti 2017 98.89% tarifë studimi dhe 1.11% te ardhura nga veprimtaria;
- viti 2018 98.05% tarifë studimi dhe 1.95% te ardhura nga veprimtaria.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

- Viti Akademik 2013-2014 ka shpenzime për paga personeli 64.69%; shpenzime për sigurime shoqërore 4.27%; shpenzime qeraje 18.45%; shpenzime të tjera 12.59%.
- Viti akademik 2014-2015 ka shpenzime për paga personeli 56.78%; shpenzime për sigurime shoqërore 6.01%; shpenzime qeraje 21.52%; shpenzime të tjera 15.70%.
- Viti akademik 2015-2016 ka shpenzime për paga personeli 56.85%; shpenzime për sigurime shoqërore 7.06%; shpenzime qeraje 17.36%; shpenzime të tjera 18.74%.
- Viti akademik 2016-2017 ka shpenzime për paga personeli 47.18%; shpenzime për sigurime shoqërore 5.67%; shpenzime qeraje 15.4%; shpenzime të tjera 31.75%.
- Viti akademik 2017-2018 ka shpenzime për paga personeli 52.41%; shpenzime për sigurime shoqërore 5.62%; shpenzime qeraje 8.73%; shpenzime të tjera 33.24%.
- Viti akademik 2018-2019 ka shpenzime për paga personeli 63.36%; shpenzime për sigurime shoqërore 5.95%; shpenzime qeraje 10.41%; shpenzime të tjera 20.28%.

Kosto e studimit për student për vit akademik llogaritur si raport i shpenzimeve për vit akademik dhe numrin e studentëve paraqitet si në vijim:

Kosto për student për vit akademik (në Eur) ka qenë:

- viti akademik 2013-2014 /1,459;
- viti akademik 2014-2015/1,100;
- viti akademik 2015-2016/1,000;
- viti akademik 2016-2017/1,246;
- viti akademik 2017-2018/1,071;
- viti akademik 2018-2019 / 1,071.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri I Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe	KU "Luarasi" auditohet, në mënyrë periodike çdo vit nga një ekspert kontabël i jashtëm i licencuar, për situatën financiare të institucionit.

<p>programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Eksperti kryen kontrollin e Bilancin Kontabel vjetor, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyrën e Lëvizjeve së Kapitalit, Pasqyrën e Flukseve të Parasë, Një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.</p> <p>Raporti i Auditit disponohet nga institucioni dhe njëkohësisht depozitohet pranë QKR – së konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>KU “Luarasi” harton raporte vjetore për çdo vit kalendarik për situatën financiare.</p> <p>Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programeve studimore ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. KU “Luarasi” realizon nëpërmjet ekspertit kontabël të regjistruar një auditim të përvitshëm, të jashtëm, të situatës financiare të tij. 2. Eksperti i jashtëm harton një raport financiar, ku parashikon kostot e programit të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e kërkuara për zhvillimin me cilësi të procesit akademik. 3. Gjëndja financiare e institucionit paraqitet e qëndrueshme, me kapacitete financiare të mjaftueshme për të garantuar ecurinë e programeve të studimit dhe përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Termu reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vëlvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e KU “Luarasi” është krijuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. NJ.B.S.C. ka përbërje të përcaktuar sipas Vendimit të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar “Luarasi” Nr. 12/4, datë 23.12.2016. Misioni i NJ.B.S.C. përfshin: Monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies; Organizimin dhe kordinimin e aktiviteteve gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm; Hartimin dhe publikimin e raporteve periodike të vlerësimit të brendshëm; Ndjekjen e procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit “Bachelor” dhe “Master”; Bashkëpunimin e vazhdueshëm me ASCAL-in për sigurimin e cilësisë; Trajnimin e personelit akademik lidhur me sigurimin e cilësisë.

Nëpërmjet vlerësimit të brendshëm të cilësisë, NJ.B.S.C. realizon qëllimin kryesor të saj, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe të kulturës së cilësisë brenda institucionit. Kjo njësi në këtë proces periodik mbikqyr, analizon dhe rekomandon rregullimet e nevojshme në drejtimet kryesore, sipas përcaktimeve të

Standardeve të cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë, dhe që konsistojnë në: Hartimin dhe miratimin e programeve; Mësimnxënia, mësimdhënia dhe vlerësimi me studentin në qendër; Stafi mësimdhënës; Burimet mësimore dhe mbështetja e studentëve; Menaxhimi i informacionit; Informimi publik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Nga takimi i zhvilluar me me pjestarët e NJBSCmorëm të dhëna se në përfundim të çdo semestri, të gjithë studentët e KU “Luarasi”plotësojnë pyetësorët në lidhje me vlerësimin e pedagogut për çdo lëndë dhe për programet e studimeve. Përmbajtja e pyetësorëve përmirësohet rast pas rast. Plotësimi i pyetësorit bëhet në mënyrë krejtësisht konfidenciale dhe vlen të theksohet se nga viti akademik 2017-2018, ky proces është kryer on-line. Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve, NJBSCPërpunon të dhënat e vlerësimit për çdo pedagog lënde. Pyetësori për vlerësimin e pedagogut përbën një ndër indikatorët më të rëndësishëm për vlerësimin e performancës së pedagogut. Jo të gjithë studentët marrin pjesë në vlerësimin on-line. Informacioni i grumbulluar përpunohet me qëllim nxjerrjen e rezultateve sa më të sakta.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve NJBSC nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog, si një indikator i rëndësishëm i performancës së tij.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJBSCmonitoron dhe menaxhon profesionalisht procesin e vetëvlerësimit të cilësië duke bashkëpunuar me GVB të fakulteteve.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Institucioni i kushton një rëndësi të madhe vetëvlerësimeve të kryera. Ky proces kryhet në mënyrë të organizuar ku përthithen edhe mendimet e studentëve për një rezultat të mirë.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike konsistojnë në fushën e sigurimit të cilësisë së mësimdhënies, në fushën e kërkimit shkencor, në fushën e akreditimit, në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit dhe sillabusave, në fushën e përditësimit të anketimeve me kërkesat bashkëkohore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	KU “Luarasi” kapjesë të strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. NJBSC, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Të dhënat e grumbulluara përpunohen nga personat përgjegjës dhe më pas i bëhen të ditura Rektorit. Në mënyrë konfidenciale rezultatet e vlerësimit të studentëve i bëhen të ditur individualisht
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.	

<p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; 	<p>edhe stafit akademik.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojta, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përfshirë sondazhet, dëgjime në auditor, rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës, rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit – tezës, rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>KU “Luarasi” harton një raport vjetor në të cilin bëhet vetëvlerësimi i brendshëm i veprimtarive akademike, shkencore dhe aktiviteteve jo akademike ku theksohen gjetjet dhe përcaktohen rekomandime për të ardhmen. Raporti vjetor dërgohet në MASR.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecursisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga biseda e kryer në institucion me përfaqësues të NJBSC, na u bë e ditur se KU “Luarasi” harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecursisë së programit të studimit të ciklit të dytë Msc_EDP. Në lidhje me këtë pikë, në përfundim të vitit akademik Dekanati dhe Departamenti i të Drejtës Penale, që është përgjegjës për programin e studimit bëjnë vlerësimin e ecursisë së programit të studimit Msc_EDP. Në përfundim të vlerësimit të programit bazuar në rekomandimet e dhëna, Dekanati sipas rastit harton politika të cilat synojnë përmirësimin cilësor të këtij program studimi.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e</p>	<p>KU “Luarasi” i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm për herë të parë në nivel institucional në vitin 2008, me urdhërin e Ministrisë të Arsimit nr. 71, datë 18.02.2008 “Për akreditimin</p>

<p>programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p><i>institucional, të programit dhe të diplomës së shkollës së lartë universitare jopublike Luarasi</i>” që është pasuar nga akreditime të programeve të studimit të realizuara nga ASCAL dhe QAA.</p> <p>KU “Luarasi” përdor instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë. NJBSC ndjek me rigorozitet zbatimin në praktikë të standardeve shtetërore të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Politika që harton KU “Luarasi” për procedurat e sigurimit të cilësisë dhe standardeve të programeve konsisto në sigurimin e cilësisë së stafit akademik dhe vlerësimit të studentëve.</p> <p>Institucioni shqyrton, miraton dhe mbikqyr në mënyrë formale të herëpashershme programet e studimit në Departament, Dekanat dhe Senat. Nisur nga ky këndvështrim Programi i studimit Msc_EDP është bërë objekt i analizave dhe diskutimeve të vazhdueshme dhe monitorimeve të vazhdueshme me qëllim që të gjithë palët pjesëmarrëse në program (stafi akademik, studentët dhe partnerët) të ndërgjegjesohen për rëndësinë e cilësisë, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</p> <p>KU “Luarasi” mbështetet në strategjinë kombëtare të Arsimit të Lartë. Përveç kësaj institucioni ka edhe strategji të tijën për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të cilën e përditëson dhe e përmirëson.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm periodik, në takimin me anëtarët e NJBSC, me stafin akademik dhe me studentët, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se:

1. Në KU “Luarasi” është ngritur dhe funksionon NJBSC, detyrat dhe funksionet kryesore të të cilës bazohen në “Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Statutin e Institucionit.
2. NJBSC e mbështet veprimtarinë e saj në rregulloren e krijuar për funksionimin e njësisë.
3. NJBSC gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj evidenton problematikat dhe sugjeron përmirësime në drejtim të cilësisë.
4. KU “Luarasi” garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron sipas një metodologie vlerësimi, me instrumente matëse dhe vlerësuese.
5. KU “Luarasi”, nëpërmjet NJBSC, harton analiza dhe raporte periodike vjetore me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
6. Institucioni jep rregullisht information objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo

Programi i studimit Msc në “E Drejtë Penale” synon formimin profesional të studentëve në të drejtën penale. Programi është i organizuar në dy vite mësimore me dy semestra secili. Programi mësimor realizohet me orë në auditor i.e. leksione dhe seminare dhe orë jashtë auditorit ku përfshihet praktika profesionale në ente publike apo private të ndryshme nga auditorët e mësimit dhe punimi i diplomës në mbyllje të vitit të dytë si edhe orë përgatitjeje individuale të studentit.

Raporti mes leksioneve dhe seminareve varion nga lënda në lëndë mbi bazën e krediteve që ka secila, po ashtu edhe koha e punës së pavarur e studentit (Shih Aneks Tab. 12). Literatura dhe materialet e tjera të detyrueshme apo mbështetëse janë kryesisht në shqip.

Në këtë Program studimi parashikohen të jepen 14 provime sipas përcaktimit të Udhëzimit MASH nr. 15 datë 4.4.2008 prej të cilave 2 provime janë praktika profesionale dhe diploma Kreditet e lëndëve të detyrueshme variojnë nga 6-10 ECTS ndërsa lëndët me zgjedhje kanë 4 kredite; Praktika ka 10 ECTS kurse punimi i temës së Diplomës/Provimi perfundimtar ka 30 ECTS (shih Aneks Tab. 13).

Në këtë Program zbatohen procedurat e transferimit të studimeve nga IAL-të e tjera sipas Rregullores së KUL neni 51 dhe 52 (Shih Aneks Tab. 20 mbi transferimet për në Institucion duke filluar nga viti akademik 2013-2014)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Penale” është licensuar me VKM Nr. 490, datë 23.06.2010 dhe akredituar për herë të parë me Urdhër të MASH Nr. 323, datë 15.08.2013. Objektivi formues i këtij Programi (Bazuar në nenin 3 të Rregullores së Programit vënë në dispozicion nga Institucioni) është:

- i. Formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e së drejtës penale.
- ii. Pajisja e studentëve me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e së drejtës ndërkombëtare penale, kriminalistikës, kriminalogjisë dhe penalogjisë, të drejtës financiare penale, veprave penale në fushën e kibernetikës.

Në mbyllje të studimeve dhe praktikës profesionale, studenti realizon një temë diplome nga alternativat e ofruara në listën e përpiluar paraprakisht nga pedagogët e angazhuar në Program.

Veprimtaritë formuese të Programit kategorizohen në përputhje me Udhëzimin MASH nr. 15 datë 4.4.2008 sikurse sqarohet nga Institucioni dhe ndahen në (shih Aneks Tab. 13):

- lëndë të formimit të përgjithshëm (A) 2 lëndë, gjithsej 14 ECTS
- lëndë të formimit karakterizues (B) 5 lëndë, gjithsej 38 ECTS
- lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese (C) 2 lëndë, gjithsej 14 ECTS
- lëndë formuese me zgjedhje (D) 2 lëndë, gjithsej 8 ECTS
- Praktika (E) 10 ECTS
- Diploma (F) 30 ECTS

GVJ kërkoi informacion gjatë vizitës mbi bazën ligjore të referencuar prej IAL-së për kategorizimin e veprimtarive formuese në Program. GVJ-sëiu komunikua se përsa i përket kategorive të veprimtarive formuese dhe raportit mes këtyre ishte zgjedhur të respektohej Udhëzimi MASH nr. 15/2008 i cila parashikon 6 kategori veprimtarish formuese (A-F) pra jo VKM n. 41/2018 që parashikon 5 kategori veprimtarish formuese (A-E). GVJ rekomandon që për vitet e ardhshme akademikët ndryshohet kategorizimi i veprimtarive formuese

konform VKM n. 41/2018 dhe kjo të pasqyrohet në *syllabus* si edhe që stafi akademik i Programit të kujdeset të respektojë raportin mes veprimtarive formuese.

GVJ vëren se IAL-ja duhet të përcaktojë qartë edhe nëse parashikon të përshijë provimin përfundimtar krahas temës së diplomës si formë të vlerësimit të dijeve përfundimtar si edhe procedurat përkatëse të aktivizimit tënjërës apo të tjetrës. Gjithsesi numri i orëve dhe ai i krediteve për punimin e temës së diplomës apo provimit përfundimtar duhet të jetë i njëjtë sepse do të cënohej raporti mes veprimtarive formuese.

GVJ vëren se VKM n. 41/2018 është një akt i cili renditet më lart në hierarki krahasuar me Udhëzimin MASH n. 15/2008. GVJ shtron për diskutim nëse Udhëzimi MASH n. 15/2008 mund të merret si referencë nga IAL-ja për disa elementë të Programit atëherë kur rregullimi nuk bie ndesh me atë të VKM n. 41/2018 ose nëse kjo e fundit nuk e ka rregulluar atë element siç ndodh p.sh për mënyrën e përcaktimit të 1 krediti (ECTS) për veprimtaritë formuese (shih treguesin më poshtë **Mënyra e përcaktimit të 1 krediti (ECTS) për format e studimit**).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Plani mësimor i Programit të studimit Msc_EDP përbëhet nga këta elementë (Shih RVB f. 70):

- Shtrihet në 2 vite akademike
- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS konvertohet në 25 orë mësimore pune të studentit
- 1 orë mësimore zgjat 50 minuta

Në Plan-Programin mësimor përcaktohet sa orë punë individuale do të kryejë studenti në varësi të orëve në auditor për secilën lëndë (Shih Aneks Tab. 12).

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në Planin mësimor (shih Aneks-Tab. 12) paraqitet ndarja e krediteve ECTS për secilën lëndë. Lëndët kanë kredite të ndryshme në varësi të rëndësisë ku lëndët e detyrueshme kanë nga 6 deri në 10 ECTS.

Mënyra e përcaktimit të 1 krediti (ECTS) për format e studimit (shih RVB f. 72):

- Leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret 5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 5 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit

GVJ vëren se meqenëse VKM n. 41/2018 nuk e ofron një skemë të tillë të detajuar i.e. 1 ECTS/Orë veprimtarie formuese do të duhet të respektohet Udhëzimi MASH n.15/2008 sipas së cilit 1 kredit ECTS për praktikën profesionale duhet të jetë i zhvilluar sipas skemës “20-25 në auditor dhe 5-0 jashtë auditorit” dhe jo “8 orë në auditor e 17 orë punë e pavarur e studentit” siç deklarohet në RVB f. 72.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

GVJ konstatoi ndryshime në Planin mësimor krahasuar me Programin e licensuar siç parashtrohet edhe nga Institucioni (shih Aneks Tab. 14)

Ndryshimet e kryera i referohen:

- Krediteve ECTS, ku pothuajse të gjitha lëndët kanë pësuar ndryshime.

- Kalimi i lëndës “Të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut në Fushën Penale” në vit të 2
- Është hequr lënda e detyrueshme “Anglishte ligjore” dhe është zëvendësuar me lëndën e detyrueshme “Psikiatri gjyqësore”
- Veprat Penale në fushën e Ekonomisë është kthyer në lëndë me zgjedhje por është e vetmja lëndë që aktivizohet *de facto* ndër alternativat e LMZ.

Ndryshimi në plan ka sjellë një diferencë prej **24** kreditesh ECTS, **20 %** të përmbajtjes së programit.

GVJ vëren se meqenëse pothuajse çdo veprimtari formuese e veçantë ka pësuar ndryshim në kredite, ndodhemi në situatën ku përmbajtja e Programit ka ndryshuar në masën e 24 krediteve ECTS për veprimtaritë formuese në kompleks i.e. 20% të përmbajtjes së Programit prej 120 ECTS. Sipas VKM n. 41/2018, IAL-ja duhet të njoftojë ministrinë përgjegjëse për arsimin, jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik, për ndryshimet deri në masën 20 për qind të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS. Edhe në rast se marrim për bazë deklarin e IAL-së se janë ndryshuar “vetëm 4 kredite ECTS” nga akreditimi i parë, VKM n. 41/2018 përcakton që për ndryshimet **deri** në masën 20%, duhet të njoftohet sidoqoftë MASR. GVJ nuk është në dijeni nëse IAL-ja ka kryer njoftimin e MASR por vëren se Udhëzimi MASR nr. 15/2008 nuk përcaktonte ndonjë kufi të ndryshimit të krediteve ECTS apo ndonjë procedurë të posaçme për njoftimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin siç parashikon VKM nr. 41/2018 që hyri në fuqi më janar 2018. Gjithashtu, VKM nr. 41/2018 nuk e ka abroguar **formalisht** Udhëzimin MASH n. 15/2008 edhe pse ky i fundit është një akt nënligjor i dalë në zbatim të Ligjit “Për arsimin e lartë” të vitit 2007 pararendës.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Shih Aneks Tab. 15)

Institucioni nuk ka parashtruar tabela të planit mësimor të lidhura me personelin akademik për vitet parardhëse nga ai akademik i 2018-2019.

GVJ shqyrtoi tabelën e anekseve të planit mësimor të lidhura me personelin akademik për vitin akademik 2018-2019, duke konstatuar se 5 PAE ishin angazhuar në mësimdhënien e 8 lëndëve (nga 12 të tilla në total) ndërsa 5 PAK janë angazhuar në mësimdhënien e 5 lëndëve në njërin prej të cilave, një PAK mbështetet nga një PAE. Në 4 lëndë, ekipi i pedagogëve është tërësisht PAK. Lëndët e detyrueshme kanë nga 6-10 kredite ECTS kurse ato me zgjedhje kanë 4 kredite ECTS.

Personeli akademik është përgjithësisht i specializuar dhe/apo ka *background* akademik në lëndën që zhvillon me përjashtim të 1 PAK/titullar, 1 PAK/jotitullar dhe 1 PAE/titullar.

RVB nuk përpunon arsyetimin në bazë të të cilit është hartuar plani mësimor dhe shpërndarja e lëndëve në vite apo semestra si edhe kreditet e caktuara secilës lëndë por shqetësimi primar ka qenë respektimi i numrit maksimal të provimeve (14 për ciklin e 2-të) parashikuar nga Udhëzimi MASR nr. 41/2008. Paçka se 70% e ngarkesës mësimore mbulohet nga pedagogë efektivë të Institucionit (nëse këta PAE do të zhvillojnë edhe ngarkesën e diplomës/provimit përfundimtar), disa lëndë zhvillohen ekskluzivisht nga pedagogë të ftuar PAK të cilët janë edhe titullarë lëndësh. Në këtë kontekst, nuk kemi të dhëna nëse pedagogët efektiv kanë prioritet në realizimin e ngarkesës mësimore të detyrueshme përkundrejt atyre PAK. Në një rast, një PAK tejkalonte normën mësimore të lejuar.

1. Sipas shënimit në Tabelën 14 të punuar nga Institucioni, duke ruajtur numrin maksimal të 14 të provimeve për Programet e ciklit të dytë të studimeve sipas Udhëzimit MASR nr. 41/2008, në Programin MSc në të Drejtë Penale “i është dhënë një peshë më e madhe lëndëve karakterizuese të programit të studimit si: *Kriminalistika, E Drejta Penale – Studime të thelluara, Kriminallogji-Penalogji* etj.” Gjatë vizitës GVJ kërkoi informacion mbi arsyet se përse “Kriminalistika” ishte cilësuar lëndë karakterizuese për Programin Msc_EDP por nuk u mor asnjë përgjigje e arsyetuar nga Institucioni (shih Minutes f. 3). Në syllabus-in e lëndës “Kriminalistika” dhe “Kriminallogji-Penalogji” është cilësuar nga titullari si “degë e së drejtës” ndërkohë Kriminalistika është studimi i zbatimit të shkencave të natyrës apo atyre mjekësore në një procedim (zakonisht) penal ndërkohë Kriminallogjia dhe Penalogjia janë lëndë ndërdisiplinore me bazë tek

shkencat sociale dhe pjesërisht tek shkenca mjekësore. Të përbashkët kanë që të dyja këto lëndë nuk i përkasin disiplinës juridike dhe kurrësi nuk mund të jenë lëndë karakterizuese për formimin e një juristi me orientim penalistik. Nga ana tjetër, kjo lëndë mund të ishte lëndë karakterizuese (B) në Masterin Profesional "Siguria dhe Rendi Publik" që zhvillohet nga po ky Institucion.

2. GVJ vëren se lëndët me zgjedhje (LMZ) janë përqendruar të dyja në vitin e II-të dhe ndërkohë që ofrohen disa alternativa përgjatë rekrutimit, gjatë vizitës GVJ-së iu komunikua që në fakt aktivizohet vetëm 1 lëndë nga secili grup-LMZ për shkak të numrit të ulët të studentëve.
3. Duke konsideruar që:
 - a. numri i studentëve të regjistruar në vitin e I-rë të Programit për vitin akademik 2018-2019 është **49 studentë** (Shih Aneks Tab. 20)
 - b. Neni 8 i Rregullores së Programit Msc_EDP përcakton që numri minimal i studentëve në ciklin e 2-të është **8 studentë**
 - c. përcaktimet mbi numrin e studentëve për kurs/grup të Udhëzimit MASR n. 41/2008 nuk zbatohen në rastet kur numri i studentëve në Program është më i ulët sesa ato të parashikuara nga Udhëzimi MASR,

GVJ vëren se studentëve duhet t'u jepet mundësia që të zgjedhin lëndën që preferojnë nëse plotësohet numri minimal i kërkuar për aktivizimin e kësaj të fundit. Në të kundërt, lënda me zgjedhje nuk do të ishte më e tillë por do kthehej në lëndë e detyrueshme. Nga ana e institucionit duhet të bëhet një punë më e madhe me qëllim që studentët që kanë zgjedhur këtë program studimi të njihen më mirë me lëndët me zgjedhje që ky program ofron, përpara se të vendosin se çfarë lënde do të zgjedhin.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre. Analizë e cilësisë së syllabuseve

Për vlerësimin e detajuar të secilit *syllabus* vënë në dispozicion në dosjen e vetëvlerësimit të IAL-së referohu tek **Tabela 16 në Aneks.**

Syllabus-i i çdo lënde duhet të përmbajë sipas VKM nr. 41/2018 këto seksione: Titullari /pedagogët e lëndës, numrin e krediteve dhe orët mësimore brenda dhe jashtë auditorit, kategorinë e lëndës (A, B, C, D, E) dhe llojin (e detyrueshme apo me zgjedhje), përshkrimin e lëndës, aftësimin e studentëve nga lënda, temat e zhvilluara çdo javë, metodologjia e mësimdhënies, detyrimet e studentit, forma e vlerësimit dhe komponentët, literaturën e detyrueshme dhe atë plotësuese. vitin akademik/semestri kur zhvillohet.

GVJ vëren se titullari i lëndës kishte firmosur rregullisht syllabus-in. Nga ana tjetër, pedagogu i ndryshëm nga titullari i lëndës që zhvillon bashkarisht me këtë të fundit lëndën, nuk është cilësuar në syllabus paçka se formati i caktuar në VKM nr. 41/2018 e detajon "Titullari/Pedagogu i lëndës".

Angazhimi i pedagogëve në zhvillimin e lëndës duhet të pasqyrohet në syllabus po ashtu siç pasqyrohet në evidencat e ngarkesës mësimore apo procesverbale provimesh pavarësisht nëse këta janë apo jo titullarë të lëndës që zhvillojnë. **GVJ rekomandon përfshirjen e pedagogëve jotitullarë që zhvillojnë lëndën në syllabus-in e saj sipas përcaktimit të VKM nr. 41/2018** meqenëse edhe Udhëzimi MASH n. 15/2008 përcakton që "*lektorët (titullarët) e këtyre disiplinave bëjnë vlerësim kolegjal të studentit, sipas modaliteteve të parashikuara në rregulloren mësimore të institucionit.*"

Leksionet dhe seminarët janë të detyrueshme për frekuentim në masa të ndryshme por në të gjitha lëndët e Programit. GVJ evidentoi dhe vuri në dijeni Institucionin gjatë vizitës se frekuentimi i seminareve në masën 75% nuk përputhet me atë të përcaktuar në nenin 8 të Rregullores së Programit Msc_EDP(80%), ndërkohë Neni 36 i Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë e përcakton si 75%.

Përpos leksioneve dhe seminareve, disa lëndë parashikojnë edhe detyra kursi si forma të vlerësimit të nxënies (përqindja e peshës që zë ky vlerësim ndryshon në varësi të lëndës) apo provime të ndërmjetme apo edhe provim me gojë. Pësia e vlerësimit për secilën nga këto forma të testimit të nxënies së dijeve nga studenti

përcaktohet në syllabus (Shih **Aneks Tab. 18**). Sistemi i vlerësimit është ai me 10 nota (4 është notë jokaluase dhe 10 nota maksimale) sipas sa përcaktuar në Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë (Neni 46).

Praktika Profesionale ka 100 orë (jashtë auditorit) dhe punimi i temës së Diplomës ka 200 orë/Provimi përfundimtar ka 250 orë. Ora mësimore zgjat 50 minuta.

Raporti i orëve të leksionit dhe seminarit ndryshon në varësi të krediteve të lëndës po ashtu si edhe puna individuale e studentit (Shih **Aneks Tab. 12**). Nga takimi me studentët, GVJ konfirmoi përdorimin e metodave të cilësuara në syllabus-e.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron Programin e studimit akredituar me Urdhër MAS n 323, datë 15.08.2013 i ndarë në lëndë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Sipas Planit Mësimor rezultojn se viti i parë akademik ka në total 8 lëndë me kredite ECTS të ndryshme i.e. lëndët e detyrueshme nga 6 deri në 8 ECTS kurse lëndët me zgjedhje 4 ECTS (Total Viti I-rë 60 ECTS). Viti i dytë ka 2 lëndë të detyrueshme me 6 ECTS dhe 2 lëndë me zgjedhje me 4 ECTS si edhe Praktikën 10 ECTS dhe Temën e Diplomës/Provimin përfundimtar 30 ECTS (Total Viti II-të 60 ECTS)</p> <p>Struktura e vitit akademik garanton që studenti që ndjek një program studimi me kohë të plotë, në përfundim të vitit akademik realizon 60 kredite. Lëndët me zgjedhje janë përqendruar të gjitha në vitin e dytë të studimeve.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave”</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë, Msc_EDP ofron njohuri të thelluara të fushës penale dhe aftësi të nivelit të avancuar profesional me synimin për të thelluar njohuritë e përfituara nga studentët në ciklin e parë të studimit.</p> <p>Programi i hartuar ka përzgjedhur lëndë të profilit penal dhe publik. Kriminalistika është cilësuar si e detyrueshme dhe ka më shumë kredite se çdo lëndë tjetër (10 ECTS) dhe është cilësuar si lëndë karakterizuese (Kategoria B) për këtë Program ndërkohë që është lëndë integruese/ndërdisiplinore dhe në programe të ciklit të dytë rezultojnë zakonisht si lëndë me zgjedhje (D) ose si lëndë integruese/ndërdisiplinore. Është cilësuar si lëndë me zgjedhje por në fakt nuk aktivizohet, lënda “E drejtë penale për të miturit” që do të përbënte lëndë karakterizuese për këtë program dhe ka relevancë dhe mund të ishte përfshirë si lëndë e detyrueshme.</p> <p>Lënda “Metodat e kërkimit në shkencat juridike” është cilësuar si lëndë karakterizuese (B) për këtë Program. Në dritën e procedurës se si përzgjidhet nga ana e studentëve tema e diplomës nga lista me alternativa e paracaktuar nga pedagogët e Programit dhe çështjes së aksesit nga studentët në bibliotekën</p>

<p>ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qarta profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>elektronike Questia (referohu në Përgjigjen e GVJ ndaj Komenteve të KUL) kjo lëndë do të ishte e cilësueshme si lëndë e formimit të përgjithshëm ose lëndë ndërdisiplinore/integruese.</p> <p>Ky program i pajis studentët me njohuri teorike dhe kryesisht praktike të metodave të hetimit penal për ata që synojnë të zhvillojnë studimet e ciklit të tretë.</p> <p>Diplomantët e këtij masteri fitojnë diplomën Master i shkencave në "E drejtë Penale".</p>
---	--

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përbajtja e programit është në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve por mund të përfitonte nga përfshirja si lëndë të detyrueshme të disa prej atyre që janë cilësuar aktualisht si lëndë më zgjedhje. Ky Program bazohet mbi ato njohuri të fituara në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bëhet si rregull bazuar në aktivizimin në seminare dhe më rezultatin në provimin përfundimtar. Disa lëndë parashikojnë që pjesë e vlerësimit të jenë edhe detyrat e kursit apo provime të ndërmjetme. Raporti mes mënyrave të ndryshme të vlerësimit përcaktohet në çdo syllabus.</p>
--	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislativon dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar duke iu referuar përvojës bashkëkohore, në konsideratë të nevojave të tregut të punës për njohuri të thelluara në fushën e së drejtës penale.</p> <p>Programi i studimit përmban kryesisht elementët e nevojshëm për të qenë ndërkombëtarisht konkurrues.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislativon.</p>
--	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi përmes lëndëve të ofruara është kryesisht në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë në shkencë penale. Mund të rishikohet që lënda "E drejta penale për të mitur" të vendoset si lëndë e detyrueshme dhe lëndës "Kriminalistika" t'i ridimensionohen kreditet ECTS e të rishikohet kategorizimi.</p> <p>Ky program është në përputhje me profilin e Kolegjit Universitar "Luarasi" dhe me strategjinë e tij.</p> <p>Personeli akademik është i aktivizuar në punë kërkimore që lidhet me mbarëvajtjen e programit. Një PAE vlerësoi si ndihmesë faktin që Institucioni nuk i ndërpret pedagogut rrogën kur i duhet të angazhohet jashtë vendit për veprimtari</p>
---	---

	kërkimore-shkencore. Gjithashtu gjatë vizitës GVJ-së iu komunikua se ekziston një fond për kërkimin shkencor në nivel Institucioni por stafi akademik i këtij Programi nuk e kishte shfrytëzuar ndonjëherë dhe nuk kishte informacion mbi ekzistencën.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	Institucioni nuk bën referim në një studim specifik aktual të tregut të punës ku bazon nevojën për këtë Program Msc_EDP. Në RVB, Institucioni i referohet një studimi të kryer në momentin e licensimit.
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	Programi Msc_EDP nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e këtyre vlerave.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	Ky program realizohet në 120 kredite dhe zgjat 2 vite akademike. Praktika mësimore ka 10 kredite kurse diploma 30 kredite.
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	Institucioni ka publikuar në faqen ëeb informacionin në lidhje me programet e studimit dhe shpërndan broshura mbi to.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Informacioni i dhënë shpjegon si zhvillohet programi i studimit, lëndët që duhet të jepen provim dhe mënyrën e diplomimit me afatet përkatëse.</p> <p>Praktika mësimore ka 10 kredite ECTS kurse Diploma 30 ECTS.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	

1. Institucioni ofron Programin “Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.
2. Programi është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Institucionit me **rekomandimin** nga GVJ që:
 - i. disa lëndë të parashikuara si lëndë më zgjedhje (specifikisht “E drejtë penale për të mitur”) të vlerësohen si thelluese të njohurive të marra gjatë ciklit të I-rë të studimeve dhe të kthehen në lëndë të detyrueshme.
 - ii. të rishikohen kreditet e lëndës “Kriminalistika” (10 ECTS) dhe cilësimi i saj si lëndë karakterizuese (B) për profilin “Jurist” në shkenca penale.
 - iii. të rishikohet cilësimi i lëndës “Metoda të kërkimit shkencor në shkenca juridike” si lëndë karakterizuese kategori B duke konsideruar që kërkimi shkencor i studentëve në formën e punimit të temës së diplomës në këtë Program është i kufizuar brenda listës me tema të paracaktuara nga pedagogët.
3. Programi është i përshtatshëm me nivelin e studimeve.
4. Programi synon të arrijë dimensione ndërkombëtare.
5. Programi përfshin aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor por ky i fundit është i kufizuar në kriteret 3 dhe 4.
6. Programi është në përputhje me nevojat e tregut ndaj GVJ rekomandon IAL-në të kryejë një studim të mirëfilltë dhe aktual të tregut të punës meqenëse në RVB i referohet një studimi të ndërmarrë para licensimit.
7. Programi synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.
8. Kohëzgjatja dhe numri i krediteve të Programi është në përputhje me aktet normative të zbatueshme ndaj.
9. Institucioni siguron manaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programin e studimit.
10. Programi parashikon një plan diplomimi.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Programi i studimit “Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale” realizohet me 120 kredite (ECTS) për 2 vite akademike. Këto kredite janë të shpërndara në 12 lëndë/disiplina, në praktikën mësimore që zhvillohet në institucionet shtetërore dhe private dhe në institucione me të cilat KU “Luarasi” ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe në provimin përfundimtar (Tema e diplomës) e cila ka 30 kredite ECTS dhe mbrohet në mbyllje të ciklit të studimeve. Kontrolli i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet provimeve finale dhe atyre të ndërmjetme në varësi të sa parashikuar në syllabus-in e lëndës. Disa lëndë parashikojnë vlerësimin e mësimnxënies bazuar edhe në detyrat e kursit sipas syllabus-it përkatës. Elementët përbërës të vlerësimit përfundimtar janë: ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve si psh detyrat e kursit, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar (**Aneks Tab. 18**).

Mësimdhënia në këtë Program zhvillohet me një turn pasdite në orarin 17.00 -20.00. Nga informacioni i marrë nga ana e Institucionit, studentët e preferojnë këtë vendosje kohore përse janë në marrëdhënie pune gjatë paradites.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

Siç shihet nga Aneks Tab. 12, 15 dhe 17. Format e mësimdhënies në këtë Program janë:

- Leksionet **600** orë mësimore në auditor
- Seminaret **255** orëmësimore në auditor
- praktika profesionale **100** orë mësimore,
- punimi i diplomës/Provimi përfundimtar **200/250** orë në auditor.
- punë individuale e studentit **1845/1795** orë jashtë auditorit

Gjithsej 3000 orë punë e studentit

Numri i temave të mësimi ndryshon në varësi të lëndës nga 7 deri në 30 tema për 15 javë mësimi (shih Seksionin e RVJ "Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre"). Po ashtu, në varësi të lëndës, ndryshon edhe numri i orëve të leksionit dhe seminarit, raporti mes këtyre si edhe puna individuale e studentit.

Nga vizita rezulton se leksioni dhe seminari i secilës lëndë zhvillohet brenda së njëjtës ditë, çdo javë. Këtu shfaqet situata efrekuentimit të detyrueshëm të leksioneve dhe seminareve në masa të ndryshme në të njëjtën lëndë që zhvillohen si rregull në po të njëjtën ditë. e. 50 % leksionet, 75% seminarët (ose 80% sipas Rregullores së Programit).

Format e kontrollit të njohurive

Kontrolli i njohurive bazohet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha që ka çdo formë e posaçme vlerësimi ka në vlerësimin përfundimtar ndryshon në varësi të sa përcaktuar nga titullari i lëndës përcaktuar në syllabus.

Format e vlerësimit për studentin janë:

- **Niveli i diskutimit në seminare**, vlerësimi për studentin varion nga 10% deri 20 %
- **Provimi i ndërmjetëm**, vlerësimi për studentin varion nga 10% deri 30 %
- **Detyra e kursit**, vlerësimi për studentin varion nga 0% deri 10%
- **Provimi përfundimtar (me gojë/shkrim)**, vlerësimi për studentin varion nga 40 % deri 70 %

Programet e lëndëve parashikojnë 2 apo më shumë prej këtyre formave të kontrollit të dijeve. Studentët vlerësohen më notën kaluese 5 deri në notën maksimale 10 sipas pikëve që shkojnë nga 0 deri në 100 sipas një skeme të përcaktuar në nenin 46 të Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Në RVB raportohet në formën e një table mbi angazhimin e studentëve në aktivitete të njësisë (Shih Aneks Tab 18) Në Aneks Tab. 22 pika 7 raportohet që **numri i studentëve të përfshirë në kërkim shkencor është 4 studentë** dhe se "**numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor**" është **0 student** kurse sipas **Aneks Tab. 19 studentët e aktivizuar** në veprimtari të njësisë për punime shkencore individuale të pedagogëve, projekte shkencore në rang njësie, projekte shkencore në rang Fakulteti dhe projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë janë përkatësisht **2, 3, 5 dhe 2 studentë**. **GVJ vëren se këto të dhëna duken në kontradiktë mes tyre.**

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Lista e veprimtarive trajnuese për studentët dhe stafin akademik në fushën e metodave të kërkimit shkencor nga pedagogë të Institucionit si edhe ai i zhvilluar nga lektorë të ftuar
- Tabelat e rishikuara të RVB të cilat sërish kanë pasaktësi dhe mangësi

- Ngarkesa totale e pedagogëve PAK dhe PAE në Program pas vërejtjeve për pasaktësi parashtruar nga GVJ në vizitë
- Raporti mbi projektet për të cilat ka aplikuar Institucioni dhe Fakulteti i Drejtësisë
- Vendim mbi emërimin e Administratorit të Institucionit

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve në KU “Luarasi bëhet në përputhje me rregullat në fuqi. Pranimi dhe regjistrimi i aplikantëve në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale” pranë KU “Luarasi”, realizohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin Nr. 18, datë 17.08.2017 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Statutin dhe Rregulloren e KU “Luarasi”, si edhe Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale”.

Kolegji Universitar “Luarasi” propozon dhe miraton çdo vit kuota dhe kriteret specifike pranimi të cilat bëhen publike në portalet e komunikimit të Kolegjit Universitar “Luarasi”, bazuar në planin e zhvillimit të institucionit duke marrë në konsideratë kapacitetet njerëzore dhe logjistike që institucioni zotëron për realizimin e tyre. Në këtë program studimi pranohen për t’u regjistruar shtetas shqiptarë dhe të huaj, që plotësojnë kushtet e vendosura nga institucioni.

KU “Luarasi ka statistika në lidhje me numrin e studentëve që kanë vazhduar studimet në këtë institucion apo edhe numrin e studentëve të punësuar. Ekzistonin marrëdhënie shumë të mira komunikimi me studentët, si gjatë procesit mësimor ashtu dhe pas diplomimit. Studentet kontaktojnë shpesh pedagogët dhe diskutojnë mbi problematikat e hasura në praktikë. KU “Luarasi” ka ngritur Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila ofron shërbimin e këshillimit të studentëve. Në këtë institucion është ngritur edhe Këshilli Studentor me senatorët përkatës për çdo grup, i kryesuar nga Presidenti. KU “Luarasi”, nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Këshillit Studentor, realizon informimin e vazhdueshëm të studentëve në të gjitha drejtimet. Pranë KU “Luarasi” funksionon edhe rrjeti i studentëve ‘ALUMNI Luarasi’, i cili bashkon të diplomuarit ndër vite.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Në programin e studimit Msc_EDP pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

1. vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga MASR).
2. vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, “Bachelor” në Drejtësi apo diplomë të studimeve Bachelor në fushën e shkencave Sociale me programe të ngjashme me fushën e Drejtësisë si: Bsc në Shkencat politike; Bsc në Diplomaci, Bsc në Marrëdhënie Ndërkombëtare, etj së bashku me certifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR,

3. personat që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e sipërmëndura.
4. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme (pika 2 dhe 3), njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program, për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre (jo më pak se 80 kredite)
5. Zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, të MAS.
6. Pranojnë pagimin e tarifës së shkollimit.
7. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

8. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
9. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Nga vëzhgimi rastësor i dosjeve për disa studentë kriteret e mësipërme ishin respektuar plotësisht.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Përsa i përket cilësisë në hyrje, nga takimet që patëm në institucion, KU “Luarasi” është i prirur të respektojë rregullat në fuqi. Përsa i përket cilësisë në dalje kjo varet nga përkushtimi i studentit për të studiuar me qëllim arritjen e rezultateve të larta. Institucioni nuk ka kriter hyres notën mesatare

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare.

Në vitin akademik 2013-2014 janë regjistruar 28 studentë dhe nota mesatare në hyrje është 7.3
 Në vitin akademik 2014-2015 janë regjistruar 40 studentë dhe nota mesatare në hyrje është 7.8
 Në vitin akademik 2015-2016 janë regjistruar 24 studentë dhe nota mesatare në hyrje është 8.2
 Në vitin akademik 2016-2017 janë regjistruar 19 studentë dhe nota mesatare në hyrje është 7.5
 Në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 33 studentë dhe nota mesatare në hyrje është 7.1
 Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 46 studentë dhe nota mesatare në hyrje është 7.5

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

KU “Luarasi ofron mobilitetin e studentëve midis institucioneve të arsimit të lartë brenda vendit. Kjo gjë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar, punësimin e studentëve (në përputhje /ose jo me diplomën)

Nga të dhënat e marra në RVB (Tabela 20 në Aneks) numri total i studentëve të diplomuar është 117 studentë

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 70 studentë.

Numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 5 studentë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Në këtë program studimi janë regjistruar student të cilët kanë plotësuar kriteret që përcaktohen në ligj për këtë cikël studimi. Të gjithë studentët e pranuar në këtë program studimi zotërojnë diplomën Bachelor me 180 ECTS.</p> <p>Pranimi në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Msc_EDP, pranë KU “Luarasi”, realizohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimeve normative të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Statutin dhe Rregulloren e KU “Luarasi”, si edhe Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Msc_EDP.</p> <p>Për t’u pranuar në këtë program studimi, zbatohen kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “E Drejtë Penale”. Gjithashtu kandidatët duhet të zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze ose të japin provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar.</p> <p>Institucioni teston vazhdimisht politikën e pranimit të studentëve në këtë program studimi dhe në përputhje edhe me strategjinë e tij harton dhe përditëson plane për ndryshimin e mundshëm të kriterëve të pranimit në respektim të dispozitave ligjore.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>KU “Luarasi” informon studentët e këtij program studimi në lidhje me punësimin që në fillim.</p> <p>KU “Luarasi” u jepet informacion të detajuar studentëve mbi akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, vlefshmërisë së diplomës, etj., nëpërmjet platformës elektronike apo fletëpalosjeve informuese.</p> <p>Në KU “Luarasi” funksionon Zyra e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës, e cila në mënyrë aktive ndihmon dhe orienton studentët në përzgjedhjen e profilizimit të tyre më të ngushtë dhe kualifikimet akademike që ata duhet të marrin.</p> <p>KU “Luarasi” ka krijuar databazën e studentëve që diplomohen me të dhënat e tyre bazë të komunikimit (numër telefoni dhe e-mail). Këto të dhëna përdoren në vijimësi edhe për punësimin dhe karrierën e tyre.</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>KU “Luarasi” disponon statistika për studentët bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>KU “Luarasi” disponon statistika për numrin e të diplomuarve, të dhëna të cilat raportohen periodikisht vit pas viti pranë MASR. Të dhënat e të diplomuarve mbahen në regjistrin bazë të studentëve, respektivisht sipas fakultetit dhe programit përkatës.</p> <p>Këto statistika janë edhe për programin e studimit Msc_EDP.</p> <p>KU “Luarasi” disponon në formë elektronike dhe të shkruar, të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të këtij programi studimor që nga pranimi deri në diplomim.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikak e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>KU “Luarasi” nëpërmjet sekretarisë mësimore, dhe Zyrës së Studentit mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të këtij programi të studimit, si dhe për vendet e punësimit të tyre.</p> <p>KU “Luarasi” disponon një bazë të dhënash për studentët që kanë vazhduar ciklin e trete të studimit pas përfundimit të këtij programi studimi.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Informacionet për programin e studimit, provimet, afatin e përfundimit të programit të studimit, statusin e akreditimit të këtij program, studentët i marrin që në momentin e aplikimit pranë sekretarisë mësimore.</p> <p>Informacioni për rezultatet e studentëve sipas formave të kontrollit të njoftuara që në fillim të procesit mësimor bëhet i vazhdueshëm nga pedagogu përgjegjës dhe sekretaria mësimore.</p> <p>Përgjegjësi i lëndës/modulit për çdo formë periodike kontrolli të parashikuar në syllabus informon studentët për rezultatet e arritura.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>KU “Luarasi” ka një stukturë të veçantë - Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila ofron shërbimin e këshillimit të studentëve. Kjo zyrë i ndihmon studentët të realizojnë ambiciet e tyre, të gjejnë veten në tregun e punës, të bëjnë aplikime të efektshme, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe për rrjedhojë të përmbushin kriteret e punëdhënësve.</p> <p>Studentët e KU “Luarasi” mbështeten dhe informohen nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës edhe për probleme më specifike që lidhen me zhvillimin e karrierës profesionale, përzgjedhja e institucionit për ta kryer atë apo udhëzime për zhvillimin e saj.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	

1. Pranimet në KU "Luarasi" për programin e studimit Msc_EDP realizohen konform të gjitha rregullave dhe procedurave ligjore në fuqi.
2. Studentëve u jepet informacion i detajuar mbi shumë çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e institucionit si: akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, vlefshmërinë e diplomës, etj.
3. Studentëve u jepet informacion i hollësishëm lidhur me mundësitë për punësim që programi ofron.
4. Raportet pedagog-student janë në nivele të mira, korrekte dhe pa probleme.
5. Në secilin prej moduleve, studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente, marrin informacione përkatëse lidhur me rezultatet e vlerësimit, si dhe diskutohen në mënyrë transparente këto rezultate.
6. Pranë KU "Luarasi" funksionon, si strukturë e veçantë, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila ofron shërbime këshillimore në dobi të studentëve për aspekte të procesit mësimor por edhe sportiv dhe social.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Institucioni në faqet 94-96 të RVB-së vlerëson se:

"Kërkimi shkencor në KU "Luarasi" zhvillohet në tre nivele mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit: Në nivel departamenti, i cili bëhet iniciator i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme shkencore, në nivel institucioni duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme me të cilat ndan të njëjtat vlera dhe synime, si edhe punë kërkimore individuale e pedagogëve të KU "Luarasi".

Qendra për Zhvillimin e Projekteve në Qendrën FAB lehtëson zhvillimin e projekteve në shkencat juridike, ekonomi, edukim, komunikim dhe teknologji informacioni, me synim përfshirjen e stafit akademik, kërkuesve të rinj dhe studentëve të Kolegjit Universitar "Luarasi" në projekte për zhvillim kapacitetesh, kërkime shkencore, studime të orientuara nga politikëbërja dhe iniciativa të tjera që lidhen ngushtë me arsimin e lartë. Qendra FAB është një strukturë bashkepunuese me Kolegjin Universitar Luarasi, por njëkohësisht bashkëpunon me një rrjet të gjerë partnerësh në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar."

KU "Luarasi" publikon revistën periodike "Mendimi" me ISSN 2311-0961 (në pritje të njohjes si revistë shkencore kombëtare nga MASR), e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit të cilët kanë detyrimin kontraktor të botojnë të paktën 2 herë në vit por edhe shkrime të studiuesve apo ish-studentëve jashtë këtij Institucioni.

Kolegji Universitar "Luarasi" ka implementuar që nga viti akademik akademik 2017-2018 projektin Klinika Ligjore "Luarasi" me staf të përbërë nga studentët e Fakultetit të Drejtësisë të drejtuar r nga pedagogët e tyre. Qëllimi i projektit "Klinika Ligjore "Luarasi", mundësuar nga Kolegji Universitar "Luarasi" dhe Fondacioni "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", është që të ofrojë ndihmë juridike falas për personat në pamundësi ekonomike për të përballuar përfaqësimin nga avokati; të përfshijë studentët e Fakultetit të Drejtësisë, në klinikë që të arrijnë të fitojnë njohuri dhe përvoja praktike në profesionin e juristit edhe para përfundimit të studimeve. Në Klinikën e Ligjit simulimi i proceseve ku studentët të

mësojnë mënyrën se si procedohet në procese penale, civile dhe administrative në sallën e gjyqit të jetë praktik pune e vazhdueshme. Qëllimi është që sa më shumë studentë të njihen me mënyrën si procedohet në një proces gjyqësor.

Aktiviteti shkencor individual i stafit akademik të Kolegjit Universitar "Luarasi" evidentohet çdo vit akademik nëpërmjet plotësimit të formularit të standardizuar mbi planifikimin (plotësohet në fillim të vitit) dhe realizimin e objektivave (plotësohet në fund të vitit). Në këtë kuadër, Institucioni ka realizuar 7* (shtatë) Konferenca Shkencore Ndërkombëtare gjatë periudhës 2014-2018.

GVJ vëren nga Aneks-Tabela 22, pika 4 se 8 (tetë) është numri i aktiviteteve ku Institucioni ka qenë organizues ose pjesëmarrës nga të cilat vetëm 2 (dy) kanë qenë konferenca ndërkombëtare.

Gjatë vizitës, GVJ u informua se ekziston një fond për kërkimin shkencor në nivel Fakulteti për të cilin personeli akademik që mund të aplikonte për mbështetje nuk kishte në fakt informacione të sakta. Institucioni vlerësoi që dhënia e lejes pedagogut që kërkon të zhvillojë një aktivitet kërkimor-shkencor jashtë vendit (për periudha të shkurtra disa-ditore) dhe mosndërprerja e pagës gjatë kësaj periudhe përbënte mbështetje financiare. Nga ana tjetër, GVJ vëren se Ligji nr. 80/2015 dhe aktet e Institucionit përcaktojnë se avancimi në karrierën profesionale dhe prodhimi i *output*-eve shkencore është detyrim i personelit akademik po ashtu siç është detyrim për IAL-në të stimulojë kërkimin shkencor tek stafi i saj efektiv. GVJ vlerëson që dhënia e lejes për të kryer kërkim shkencor jashtë vendit apo mosprerja e pagës nuk mund të cilësohet mbështetje e aq më pak stimulim kur kjo shpërbëje është detyrim i IAL-së ndaj pedagogut që ka punësuar nga i cili pretendon të rritet profesionalisht.

Gjatë vizitës, GVJ-ja u vu në dijeni nga përfaqësues të stafit akademik efektiv se mbështetje financiare për kërkim shkencor konsiderohej të ishte edhe mospagesa e *fee*-së për të marrë pjesë në konferencat shkencore të organizuara nga Institucioni dhe se në mënyrë të përciptë kishin informacion se 2 kolegë nga strukturat e tjera të Institucionit ishin angazhuar në veprimtari kërkimore-shkencore në kuadrin e FAB në Bolonja dhe Zagreb (Shih Aneks Tab. 22, pika 6). Fakti që informacioni i disponuar nga stafi akademik efektiv i Programit ishte i përciptë tregon se objektivi strategjik për një shpërndarje të rregullt të informacionit mbi mbështetjen institucionale për aktivitetin akademik dhe kërkimin shkencor tek studentët dhe pedagogët nuk është realizuar (shih Evidencën nr. 2), **Plani Strategjik për 2016-2020**, f. 15-16GVJ ka konstatuar që stafi akademik i Programit deri më tani nuk ka përfituar asnjëherë nga fondi për zhvillim profesional të parashikuar nga KUL në "Strategjia e kërkimit shkencor të Kolegjit Universitar "Luarasi" 2018-2019" që në realitet konsiston në një plan të kërkimit shkencor në kuptimin e punës shkencore që pritet nga stafi akademik në vend të njëstrategjie të mirëfilltë çka iu vu në vëmendje nga GVJ gjatë vizitës. KUL duhet të bëjë më shumë përpjekje me qëllimin e rritjes së fondeve për zhvillimin profesional të personelit akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Për të dhëna të detajuara mbi kërkimin shkencor të stafit akademik të Programit dhe studentëve** referohu tek Aneks-Tabelat n. 22 dhe 23.

GVJ vuri në dijeni përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës se në disa raste CV-të nuk janë të përditësuar aq sa shtyn që ta parashtrijë si një rekomandim për të ardhmen. Gjithashtu GVJ vërejti edhe disa problematika mbi elementët që sigurojnë karakterin shkencor të botimeve (shih Treguesin "Numri i botimeve" me poshtë).

Projekt i fituar dhe në zbatim aktualisht është ai në bashkëpunim me Fondacionin "Shoqëri e hapur për Shqipërinë"

- Studentët e angazhuar në kërkim shkencor** raportohen të jenë 4 (Aneks Tab. 22) por nuk sqarohet në cilin aktivitet prej atyre të listuara në po këtë tabelë. Gjatë vizitës nuk u morën informacione mbi këtë çështje.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i angazhuar në Program

Për përmbledhjen e botimeve shkencore të secilit PAE dhe PAK të Programit referohu tek Aneks-Tabela 23 duke konsideruar edhe kohëzgjatjen e angazhimit të tyre në Program.

GVJ vëren se në disa raste nuk është cilësuar nëse punimet kanë karakter shkencor i.e. monografitë kanë recensë shkencore dhe numër ISBN, artikujt janë botuar në revista shkencore të njohura nga MASR apo prezantimet në konferenca/simpoziume janë botuar në *book of proceedings*.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Raport për projektet në fazë aplikimi dhe realizimi të Institucionit.
- Pasqyra e përmbajtjes së një numri të Revistës “Mendimi” ku ka botuar student (tip)
- Trajnim për studentët për metodat e kërkimit shkencor drejtuar nga Dr. NXh.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Nga 10 pedagogë jo/efektivë, 2 PAK dhe 1 PAE nuk kanë deklaruar asnjë punim kurse 1 PAK nuk ka botuar asgjë gjatë periudhës 2013-2019. Disa nga raportimet mbi prezantimet në konferenca dhe artikuj në revista kanë pasaktësi ose janë të paplota (shih Aneks Tab. 22 dhe 23 mbi botimet e pedagogëve). Gjithashtu nuk evidentohet nga Institucioni nëse revistat kombëtare ku kanë botuar pedagogët janë njohur si shkencore me akt të MASR.</p> <p>Asnjë pedagog nuk ka botuar në revista me faktor impakti të rankuara nga Scopus/Thomson Reuters siç kërkohet nga VKM nr. 112/2018 i cili sidoqoftë ka hyrë në fuqi shumë pak kohë përpara aplikimit nga IAL për akreditim. 1 PAK ka botuar 2 monografi (nuk cilësohet nëse me karakter shkencor dhe me recensë) në gjuhë të huaj në fushën e tij të interesit kërkimor-shkencor dhe ka punuar 2 tekste në shqip “<i>për përdorim të brendshëm</i>” (nuk është e qartë nëse këto të fundit janë botuar dhe kanë ISBN)</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Nuk evidentohen raste të mësimdhënies në gjuhë të huaj apo që IAL-ja të ketë parashikuar dhe zbatuar lëndë në gjuhë të huaj të ndryshme nga vetë “Anglishtja juridike” parashikuar në Programin Bachelor.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit</p>	<p>Sipas RVB (f. 103) në muajin maj 2019 Institucioni është bërë pjesë e rrjetit UNIADRION (Adriatic Ionian Network for</p>

<p>mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Universities, Regions, Chamber of Commerce and Cities), rrjet që ka për qëllim të bashkëpunojë së bashku në Projektet Globale të Kërkimit Shkencor, dhe projekteve në fushat e Jurisprudencës, Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit.</p> <p>Atualisht rezulton të jetë aktiv për stafin akademik të Fakultetit të Drejtësisë, Programi Master i Shkencave, 1 marrëveshje me Universitetin e Barit kurse janë në pritje të përgjigjes nga Universiteti i Bolonjës dhe Universiteti i Foggia-s (Dokumenti nr. 8 i marrë gjate vizitës përcjellë nga Institucioni i raporton të treja si marrëveshje aktive).</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion me anëtarë të zyrës së kërkimit shkencor rezulton që pedagogët kanë marrë pjesë në 2 trajnime mbi metodat e kërkimit shkencor të organizuar nga Dr. Nazmi Xhomara dhe nga lektorë të ftuar të huaj (Dok. N. 2-5 dhe nr. 13 tek Vizita)</p>
---	---

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për veprimtarinë kërkimore-shkencore apo pjesëmarrjen në projekte të stafit akademik. Këto të dhëna ka nevojë të përditësohen, të plotësohen sipas treguesve të avancimit në karrierën akademike të pedagogut të përcaktuar nga VKM n. 112/2018 i.e. botime në revista të rankuara nga Thomson-Reuters/Scopus, konferenca ndërkombëtare në vende të OECD/G20/BE-së, revista kombëtare shkencore të njohura nga MASR etj. Gjithashtu këto të dhëna duhet të integrohen përsa rezultuan të shpërndara në dokumenta të ndryshme (shih Dok. N. 2-9 tek Seksioni Vizita dhe Evidencat e DVV)</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Një pjesë e stafit akademik të Programit nuk kanë raportuar mbi punën kërkimore-shkencore të botuar, disa kanë pasaktësi ose të dhënat janë të paplota. Punimet shkencore të deklaruara janë kryesisht prezantime në konferenca (nuk saktësohen nëse janë botuar në *proceedings*) ose artikuj shkencore kombëtarë (nuk saktësohet nëse revistat kombëtare janë shkencore miratuar nga MASR).

Monografi shkencore në gjuhë të huaj të fushës në të cilën lëvrohet nga pedagogu rezulton të ketë publikuar vetëm një PAK (2 botime). Ndër pedagogët PAE/PAK që kanë botuar punimë shkencore, 1 PAK dhe 2 PAE të Departamentit të së Drejtës Penale kanë lëvruar në fushën e tyre kërkimore-shkencore. Gjithashtu, 1 PAE (TIK) dhe 2 PAK nuk kanë raportuar asnjë punim shkencor kurse 1 PAK i Departamentit të së Drejtës Publike nuk ka botuar asnjë punim shkencor nga 2013-2019.

Puna shkencore mungon si deklarim në CV-të e disa pedagogëve, çka u vu në dukje nga GVJ gjatë vizitës. Asnjë pedagog nuk ka botuar në revista të rankuara nga Thomson Reuters/Scopus dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore në vende të OECD/BE/G20 nuk është specifikuar në deklarinimin e Aneks-Tab. 22 përcjellë nga Institucioni por nga verifikimi i GVJ rezulton të jetë kryer si veprimtari nga 1 PAK dhe 1 PAE i Departamentit të së Drejtës Penale.

Stafi akademik efektiv nuk rezulton të ketë informacion të mjaftueshëm mbi mundësitë për mbështetje financiare të iniciativave individuale për kërkim shkencor. Detyrimi për të botuar të paktën 2 herë në vit tek Revista "Mendimi" (e cila nuk merret parasysh për efekt të promovimit të stafit akademik sipas VKM nr. 112/2018 përsa nuk është e njohur nga MASR si revistë shkencore), që është përcaktuar edhe

si shkak për zgjidhjen e kontratës së punës nëse nuk përmbushet nga pedagogu-punëmarrës, bën që PAE të ndodhen përballë një trysnie të konsiderueshme ku u duhet të përballojnë individualisht nga pikëpamja financiare detyrimet për të prodhuar *output*-e shkencore, përpos realizimit të veprimtarisë mësimdhënëse brenda dhe jashtë auditorit.

GVJ konkludon që në gjendjen aktuale, Institucioni nuk i mbështet mjaftueshëm pedagogët efektivë në realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore. Kjo reflektohet edhe në cilësinë e mësimdhënies të ofruar në Program ku studentët janë të detyruar të ndjekin lëndë formalisht “me zgjedhje” apo të punojnë tema diplome të paracaktuara në një listë. Në këto kushte çënohet liria akademike dhe rrjedhimisht, pengohet mësimdhënia cilësore çka përbën problem përderisa universitetet shqiptare janë me orientim **kryesisht** mësimor.

Mbështetja e KUL ofruar Fakultetit të Drejtësisë dhe stafit akademik të Programit konsiston në fitimin dhe realizimin e projektit “Klinika e Ligjit” në bashkëpunim me Fondacionin “Shoqëria e hapur për Shqipërinë” dhe 2 Konferenca ndërkombëtare organizuar më prill 2017 dhe maj 2018 në të cilat kanë referuar 2 PAE dhe 1 PAK dhe gjatë vizitës GVJ-së iu komunikua që stafi akademik efektiv është përjashtuar nga pagesa e *fee*-së.

Nga 10 pedagogë në total të angazhuar në Programin që lëvron në të drejtë penale, 5 janë të fushës penale (3 PAE dhe 2 PAK) dhe 5 janë të fushës publike/formim i përgjithshëm (2 PAE dhe 3 PAK). *Outputi* kërkimor-shkencor për periudhën 2013-2019 i pedagogëve të angazhuar në mësimdhënien e Programit është minimal. Edhe aty ku *output*-i ka relevancë referuar natyrës së Programit, GVJ vlerëson që Institucioni nuk ka patur ndikim të vlerësueshëm në realizimin e këtij *outputi* duke mbetur përpjekje dhe sukses individual i pedagogut.

2. IAL-ja nuk ka parashikuar mësimdhënie në gjuhë të huaj për studentë të huaj.
3. Janë ndërmarrë në total 1 trajnim për pedagogë mbi metodat e mësimdhënies dhe 2 trajnime për studentët (Bachelor dhe MSc+PhD candidate) mbi mënyrën si të punohet një *essay* apo një artikull shkencor. Prodhimi i *output*-eve shkencore i caktuar si detyrim si nga ligji ashtu edhe në kontratën e punësimit me Institucionin, mbeten në ngarkim të pedagogut i cili përballon kostot intelektuale dhe financiare personalisht.
4. IAL-ja disponon të dhëna për veprimtarinë kërkimore-shkencore të stafit efektiv dhe atij me kohë të pjesshme por këto duhet të përditësohen, plotësohen dhe integrohen në mënyrë që edhe analiza e brendshme e cilësisë sipas treguesve të jetë e saktë.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

IAL-ja ka nënshkruar marrëveshje shkëmbimi stafi akademik dhe studentësh që interesojnë edhe Fakultetin e Drejtësisë me Universitetin e Barit dhe është në pritje të përgjigjes nga 2 universitete italiane të tjera (shih Dok. N. 8 tek Seksioni Vizita). Këto marrëveshje parashikojnë shkëmbim personeli akademik, kryerjen e praktikave të studentëve, shfrytëzimin e materialeve arkivore, organizimin e konferencave shkencore etj. Në rastin e shkëmbimit të studentëve mund të deduktohet që në momentin e zbatimit të marrëveshjes do jenë vetëm studentë shqiptarë ata që do vizitojnë IAL-të italiane përse Institucioni nuk parashikon programe në gjuhë të huaj.

Nuk rezulton që pedagogë efektivë të Programit apo të Fakultetit të Drejtësisë të kenë kryer periudha kërkimore jashtë vendit por Institucioni ka aplikuar në Programin Erasmus +. Institucioni raporton mbi pjesëmarrjen e 2

personave në veprimtari me karakter kërkimor-shkencor në kuadrin e rrjetit UNIADRION (Adriatic Ionian Network for Universities, Regions, Chamber of Commerce and Cities), për të bashkëpunuar në Projektet Globale të Kërkimit Shkencor, Projekte në fushat e Jurisprudencës, Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit (Shih Aneks Tab. 24) por gjatë vizitës GVJ-së iu komunikua që nuk ishin pedagogë apo studentë të Fakultetit të Drejtësisë.

Institucioni mban lidhje të ngushta me administratën publike dhe biznesin (shih RVB f. 105 dhe Aneks Tab. 25). Kështu studentët e këtij programi kanë zhvilluar praktikën mesimore si në sektoret shtetëror penitenciar ashtu dhe në organizata private. Institucioni ka lidhur marrëveshje me disa institucione të administratës publike si p.sh Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve Marrëveshje, me organizata si p.sh Balkans Youth Council, Dhoma Nderkombetare e Ndermjetesve (DHKN), Shoqata e Avokatëve Penaliste si edhe me përfaqësues të komunitetit të biznesit SiCRED SH.A, Hysenbelliu Grup etj.

Institucioni ka ngritur Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila ofron shërbimin e këshillimit të studentëve dhe integron të dhënat në databazën e studentëve që diplomohen (numër telefoni dhe e-mail), dhe mban rrjetin Alumni me të dhënat e ish-studentëve të punësuar e në karrierë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Aneks Tab. 24)

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projektin “Klinika e Ligjit” është 4
- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore është 0
- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL është 0
- Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit në nivel IAL -je të ndryshëm nga Fakulteti i Drejtësisë është 2.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Aneks Tab. 25)

Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita ne Institucion rezultoi se Kolegji Universitar “Luarasi” ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të huaja dhe vendase, një pjesë me qëllim shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve dhe një pjesë me qëllim realizimin e praktikave profesionale/mësimore. Sa i përket shkëmbimit të stafit pedagogjik dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë me ata të një IAL-jë të huaj, ende nuk është realizuar si veprimtari.

Nga ana tjetër praktika mësimore/profesionale e studentëve është realizuar rregullisht. Nga vizitanë Institucion dhe takimi me studentët rezulton që janë këta që zgjedhin institucionin ku të zhvillojnë praktikën por IAL-ja i suporton dhe i orienton në rast se u nevojitet udhëzim mbi zgjedhjen më të përshtatshme. Gjithashtu studenti ndiqet nga pedagogët që ndërmjetësojnë komunikimin nëse është e nevojshme mes praktikantit dhe institucionit ku do zhvillohet praktika profesionale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Studenti i Programit tipikisht zgjedh vetë vendin/ institucionin ku kryen praktikën.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara	Institucioni ka lidhur marrëveshje me disa ente publike dhe private në të cilat mund të drejtojë studentin që nuk arrin të gjejë vetë ku të zhvillojë praktikën. Kjo procedurë është

<p>të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>mjaftueshmërisht fleksibël për studentin</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Informacioni shkëmbehet rregullisht midis anëtarëve të personelit akademik.</p> <p>Njësitë kryesore dhe bazë organizojnë takime e analiza periodike për aspekte të ndryshme të punës në institucion dhe sigurojnë kolegjalitetin e nevojshëm në vendimmarrjet më të rëndësishme.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për realizimin e objektivave të programit të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorë biznesi - ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për të mundësuar kryerjen e praktikave profesionale nga studentët. Këto marrëveshje parashikojnë shkëmbim personeli akademik, kryerjen e praktikave të studentëve, shfrytëzimin e materialeve arkivore, organizimin e konferencave shkencore - ka realizuar trajnime, workshop-e dhe në një rast janë përfshirë lektorë të huaj - Institucioni nuk ka vënë në dispozicion ndonjë raport mbi benefitet nga marrëveshjet me institucionet e ndryshme.
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas dhe me institucione publike që ndihmojnë në zhvillimin e praktikave mësimore/profesionale të studentëve. 2. Institucioni siguron komunikim të frytshëm me personelin e tij. 3. Institucioni ka lidhur marrëveshje kuadër me një IAL italiane dhe është në pritje të lidhë 2 të tjera në kuadrin e shkëmbimit të stafit pedagogjik dhe atë të studentëve por meqenëse këto marrëveshje nuk janë implementuar, nuk ka ende të dhëna mbi benefitet prej këtyre. <p>Rekomandim:</p> <p>Të implementohen marrëveshjet kuadër që KUL ka nënshkruar me IAL-të e huaja ndër vite me objekt mobilitetin e studentëve dhe atë të stafit akademik.</p>	

I. ANALIZË PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KËSHILLI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

Rekomandimet e mëposhtme janë plotësuar plotësisht:

- Të bëhen përpjekje për të rritur numrin e pranimit në këtë program studimi, në përmbushje të interesave të studentëve për të mos e vazhduar organizimin e mësimit gjithmonë pasdite.

Rekomandimet e mëposhtme janë plotësuar kryesisht:

- Të mbahet një ekuilibër dinamik në çështjen e ndërtimit të punës së personelit akademik mbi kërkimin shkencor të studentëve.
- Të bëhen më shumë përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik efektiv

Rekomandimi i mëposhtëm nuk është plotësuar:

- Të përmirësohet shpërpjestimi që ekziston për raportin pedagogë të brendshëm – pedagogë të jashtëm duke siguruar në rekrutimet e personelit të pedagogëve kriterin e cilësisë, bazuar në profilin e spikatur, karrierën në fushën përkatëse, përvojën në mësimdhënie dhe punën kërkimore e botuese.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm posaçërisht për të. Institucioni ka ngritur strukturat dhe ka prodhuar aktet e brendshme si Statutin dhe Rregulloren e IAL-së, Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Rregulloren e Programit Msc_EDP. Ka disa mospërputhje mes parashikimeve të këtyre akteve me njëra-tjetrën siç u përcollën nga GVJ gjatë vizitës.
- 2) IAL-ja ka njëpozicion të favorshëm urban dhe i ofron Programit një infrastrukturë të qëndrueshme përfshirë edhe një Laborator të Kriminalistikës dhe një të Informatikës.
- 3) Stafi ndihmës-akademik janë një mbështetje solide për Programin.
- 4) Ngritja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
- 5) Sistemet elektronike dhe aplikacionet e zhvilluara nga IT-ja dhe stafi i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit për manaxhimin e të dhënave dhe veprimtarive të IAL-së p.sh *Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS)*.
- 6) Marrëveshjet me entet publike dhe private që i mundësojnë studentëve të kryejnë praktikën mësimore/profesionale.
- 7) Marrëveshje kuadër që synojnë realizimin e shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve dhe pjesëmarrës në Programin Erasmus +. Për momentin këto shkëmbime potenciale do të jenë të njëanshme, nga KUL për tek IAL-të e huaja meqenëse KUL nuk ka kurse studimi në gjuhë të huaj.
- 8) Mbajtja e kontakteve me studentët nëpërmjet rrjetit Alumnitë cilët angazhohen në botimin e punimeve shkencore edhe pas përfundimit të studimeve në KUL.

b. Pika të dobëta:

- 1) Personeli akademik PAE dhe PAK është pjesërisht i pajisur me kualifikimet akademike dhe profesionale të nevojshme për lëndët që zhvillon në këtë Program. Ka titullarë PAK që nuk mbështeten nga PAE ose që u mungon grada shkencore “Doktor”.

- 2) Prodhimi i *output-eve* shkencore i caktuar si detyrim si nga Ligji po ashtu edhe në kontratën e punësimit me Institucionin, mbeten në ngarkim të PAE i cili përballon kostot intelektuale dhe financiare personalisht.
- 3) Aktivitetet shkencore të organizuara nga IAL-ja konform kritereve të VKM nr. 112/2018 dhe VKM nr. 467/2007 (e ndryshuar) pararendëse mbi kriteret për promovimin e personelit akademik janë në numër të ulët i.e. 2 konferenca shkencore ndërkombëtare.
- 4) Pjesëmarrja e ulët e stafit akademik të Programit/Departamentit në programe apo projekte kërkimore. Aktualisht po realizohet 1 projekt në bashkëpunim me një OJF.
- 5) Mungesa e periudhave të shkëmbimit të personelit akademik apo të studentëve (të Programit apo të Fakultetit të Drejtësisë).
- 6) Stafi akademik i Programit derimë tani nuk ka përfituar asnjëherë nga fondi për zhvillim profesional të parashikuar nga KUL.
- 7) Performanca përgjithësisht e dobët në publikime shkencore referuar kritereve të VKM n. 112/2018 por edhe atyre të VKM n. 467/2007 (e ndryshuar) pararendëse.
- 8) Pasaktësi dhe mangësi në deklaram në RVB, në tabela, syllabus-e dhe CV të papërditësuara që krijojnë vështirësi serioze në vlerësimin e performancës së stafit akademik, të Institucionit si nga ana e GVB ashtu edhe nga GVJ.

c. Mundësitë:

- 1) Departamenti mund të përcaktojë fushat e interesit ku studentët e Programit të kryejnë kërkim shkencor duke prodhuar temën e diplomës pa përcaktuar në mënyrë strikte temat që duhet të zhvillojnë diplomantët.
- 2) Institucioni mund të ndërmarrë ose t'i referohet një studimi të tregut të punës më aktual sesa ai i cituar në RVB i vitit 2010.
- 3) Meqenëse për kategorizimin e veprimtarive formuese dhe shpërndarjen e krediteve ECTS në Program është përzgjedhur të zbatohet Udhëzimi MASH n. 15/2008, Institucioni mund të konformohet për vitet e ardhshme akademike me VKM n. 41/2018.
- 4) Studentëvemund t'u jepet mundësia që të zgjedhin lëndën që preferojnë nëse plotësohet numri minimal i kërkuar për aktivizimin e kësaj të fundit dhe jo thjesht të aderojnë detyrimisht tek lënda që ka numrin më të madh të studentëve të regjistruar.
- 5) Funksionimi i Qendrës FAB (Kërkimi Shkencor, Projektet dhe Inovacioni) si strukturë ndërlidhëse mes IAL-së, përfshirë edhe Fakultetin e Drejtësisë dhe partnerëve ndër/kombëtarë
- 6) Në kuadrin e konformimit me VKM n. 41/2018 për vitet e ardhshme akademike, mund të rritet numri i pedagogëve që do të mbikqyrin praktikën mësimore të studentëve.
- 7) Meqenëse Revista "Mendimi" nuk është njohur si shkencore me akt të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, publikimi nga ana e stafit akademik efektiv mund të mos jetë i detyrueshëm e aq më pak shkak për zgjidhjen e kontratës së PAE përsa çënon lirinë akademike.
- 8) Përfaqësimi gjinor mund të rritet në nivel njësie bazë në Departamentin Penal me jo më pak se 30% për secilën gjini. Gjithsesi, Institucioni e ka respektuar këtë raport në nivel njësie kryesore (FD) në masën 62%:38%
- 9) Numri i pedagogëve efektivë të kualifikuar në fushën shkencoretë angazhuar në këtë Program studimi si pjesë e organikës së DDP mund të rritet, meqenëse krahasuar me vitin 2013 rritja me 1 PAE rrjedh nga aganzhimi i 2 PAE të strukturave të tjera të KUL.

d. Pengesat:

- 1) Burimi kryesor i financimit mbeten tarifat e shkollimit të studentëve.
- 2) Mosparashikimi i kurseve të studimit në gjuhë të huaj përjashton mundësinë e shkëmbimit të studentëve për tek KUL.
- 3) Ndryshimet ligjore në rregullimin e elementëve të programit të studimit dhe kritereve për fitimin e titujve dhe gradave që ndikojnë në vlerësimin e punës së stafit akademik efektiv.

Rekomandime/Sugjerime:

1. T'u sigurohet stafit akademik dhe studentëve aksesin në burime bibliografike të përditësuara, përfshirë edhe ato me karakter elektronik.
2. Të rishikohen neni 26 pika b) e Statutit dhe neni 8 i Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë për sa ia akordojnë Përgjegjësit të njësisë bazë disa kompetenca që në fakt Ligji nr. 80/2015 ia ka caktuar njësisë bazë si organ kolegjal, jo drejtuesit të kësaj të fundit.
3. Departamenti, më së shumti, mund të caktojë fushat e interesit për temat e diplomës që do punohen nga studentët pa kufizuar këta në përzgjedhjen e objektit specifik të temës së diplomës sipas një liste.
4. Të ndryshohet për vitet e ardhshme akademike kategorizimi i veprimtarive formuese të Programit konform VKM n. 41/2018 dhe kjo të pasqyrohet në syllabus.
5. Syllabus-et të përditësohen me punën shkencore të saktësuar sipas elementëve të konsideruar në VKM n. 112/2018. Gjithashtu syllabus-et të përmbajnë identitetin edhe të pedagogëve jotitullarë të lëndës që zhvillojnë mësim konform VKM n. 41/2018. Titullari i lëndës duhet të jetë ekspert i fushës me gradën shkencore "Doktor" meqenëse ndodhemi në ciklin e II-të të studimeve. Programet e lëndëve të pasqyrohen edhe në faqen web të IAL-së.
6. IAL-ja duhet të përcaktojë nëse parashikon të përfshijë Provimin Përfundimtar krahas Temës së Diplomës si formë të vlerësimit të dijeve përfundimtare edhe procedurat përkatëse të aktivizimit të njëjës apo të tjetrës në aktet e saja të brendshme.
7. Të rishikohet:
 - kategorizimi i disa lëndëve me zgjedhje në favor të cilësimit të tyre si të detyrueshme për profilin jurist në shkencë penale (veçanërisht të lëndës "E drejtë penale për të mitur"). Lëndët me zgjedhje të jenë realisht të tilla, pra studenti të mund të zgjedhë mes atyre të ofruara nga programi.
 - Të rishikohet shpërndarja e krediteve të disa lëndëve dhe cilësimi i tyre si lëndë karakterizuese (B) për profilin "Jurist" në shkencë penale në favor të cilësimit të tyre si lëndë ndërdisiplinore.
8. Të synohet organizimi dhe pjesëmarrja e PAE në aktivitete shkencore konform kritereve të VKM nr. 112/2018, mbi kriteret për promovimin e personelit akademik.
9. Të stimulohen dhe të suportohen financiarisht periudha shkëmbimi të personelit akademik apo studentëve të Programit apo të Fakultetit të Drejtësisë qofshin këto edhe afatshkurtra.
10. Institucioni t'i referohet një studimi të tregut të punës të vonshëm për sa në RVB i referohet studimit të tregut të punës në kohën e licensimit.
11. Diploma të mbulohet nga PAE në vitet e ardhshme akademike në mënyrë që mbulimi i ngarkesës mësimore nga PAE të jetë konform rregullimit ligjorë fuqi.

SWOT Analysis

a. Strengths

- 1) This program is structured in compliance to the legal framework applicable. The HEI has erected the structures and produced the internal by-laws such as the Statute and the Regulation of the HEI alongside the Regulation of the Faculty of Law and that of the Program. There are a few discrepancies between several provisions of these acts which were brought up during the visit by the EEG (GVJ) as well as in this Report.
- 2) HEI provides for a favourable location to the persons engaged in the Program with a sustainable infrastructure that includes a Forensic as well as an Informatics Laboratory.
- 3) The administrative staff is a solid aide to the needs of the Program.
- 4) The creation of the Internal Quality Assurance Unit.
- 5) The electronic systems and applications developed by the IT unit and the Faculty of Information Technology and Innovation regarding the management of data and activities on part of HEI.
- 6) The agreements with both private and public entities providing chances for the students of the Program to engage in practical as well as professional internships.
- 7) Framework agreements aimed at academic staff members as well as students' exchange within the Erasmus + Program. Currently the eventual mobility will be one sided i.e. from HEI to the foreign institution as HEI does not provide for courses of study in a foreign language.
- 8) The Alumni network is active and it allows for opportunities to publish in the HEI's journal even after the studies in this institution are completed.

b. Weaknesses

- 1) The part-time and full-time academic staff members engaged in the Program are partially qualified for the courses of study they teach in. There were cases of part-time lecturers either directing (*titullarë*, alb) a course of study without the support of a full-time lecturer or lacking the PhD degree.
- 2) The full-time members of the academic staff covers the intellectual as well as financial costs of producing scientific outputs which both the law and the employment contract with HEI provide as being an obligation to be fulfilled by the staff and reviewed annually.
- 3) Few activities organized by HEI in compliance to both the criteria set by DCM n. 112/2018 and the previous DCM n. 467/2007 (amended) on the promotion of the academic staff i.e. 2 international conferences since 2013.
- 4) Low participation rate on part of the full-time academic staff members of the Program/Department in research activities and projects.
- 5) Lack of exchange periods on part of the full-time members of the academic staff and of the students of the Program/Faculty of Law.
- 6) The full-time members of the academic staff have yet to benefit from any financial support stemming from the HEI's professional development fund.
- 7) Overall poor performance in scientific publications compliant to the criteria set by DCM n. 112/2018 and the previous DCM n. 467/2007 (amended).

- 8) Inaccuracies and voids in the declarations contained in the IER (RVB), tables and outdated CVs which create serious difficulties in the evaluation of the performance of the academic staff as well as of HEI, on part of both the IEG (GVB) and the EEG (GVJ)

c. Opportunities

- 1) The Criminal Law Department may set the research interests for the students of the Program to be developed in their diploma thesis without binding them to select one of the topics listed by the Department.
- 2) HEI may produce or refer to a more updated study of the labour market than that of 2010 cited in the IER (RVB).
- 3) HEI can conform to the criteria set by DCM n. 41/2018 on the elements of the program, specifically on what concerns the categorizations of the educational activities and the distribution of the ECTS credits for the future years, since currently it refers to the previous Directive of the Ministry of Education n. 15/2008.
- 4) Students will be given the possibility to choose the subject they prefer, if the minimum number required in order for it to be active is fulfilled. They will not be obliged to adhere to the subject which has the largest number of students enrolled.
- 5) The functioning of the FAB Center (Research, Projects and Innovation) as a linking structure between the IAL, including the Faculty of Law and national/international partners
- 6) In accordance with the DCM No. 41/2018 regarding the next academic years, the number of lecturers who will oversee the students' teaching practice may increase.
- 7) As "Mendimi" journal has not been recognized as a scientific one by the Ministry of Education, the publication of it by the effective academic staff may not be mandatory, much less to cause the termination of the full-time lecturers (PAE) contract, as it infringes the academic freedom.
- 8) Gender representation can be increased in the basic unit level for the Criminal Law Department by not less than 30% per each gender. However, the Institution has respected this ratio in the Main Unit level (i.e. Faculty) by 62%: 38%
- 9) The number of effective lecturers properly qualified, engaged in this study program as part of the Department of Criminal Law's (DDP) staff can be increased, since compared to 2013 the increase of 1 PAE results from the commitment of 2 PAE of other HEI's structures.

d. Threats

- 1) The main source of funds remains student tuition fees.
- 2) Failure to provide foreign language study courses precludes the possibility of KUL to exchange students.
- 3) Change of the law regulating the program of study elements and the criteria necessary to be fulfilled in order to earn degrees that affect the evaluation of the work of the effective academic staff.

Recommendations/Suggestions

- 1) *Provide academic staff and students with access to up-to-date bibliographic resources, including those of an electronic nature.*

- 2) *Revise Article 26 (b) of the Statute and Article 8 of the Rules and Procedures of the Faculty of Law since they confer on the Head of the Base Unit certain powers which in fact Law no. 80/2015 has assigned to the base unit as a collegial body, not just the head of the latter.*
- 3) *The department can, at most, designate the areas of interest for the final paper topics to be worked on by the students without limiting them to selecting a specific subject out of a list.*
- 4) *The categorization of the formative activities of the Program should be changed according to the DCM No. 41/2018 for the next academic years and this should also be reflected in the syllabus.*
- 5) *The syllabuses should be updated with the scientific work according to the elements specified in the DCM. No. 112/2018. The syllabuses should also contain the names of the lecturers who do not hold any subject in accordance with the DCM No. 41/2018. The subject holder must be an expert in the field of research of his PhD degree since we are in the second cycle of studies. The syllabuses of the courses should also be reflected on the IALs website.*
- 6) *IAL should determine whether it intends to include the Final Exam alongside the Diploma Thesis as a form of final knowledge assessment and the relevant activation procedures of one or the other in its internal acts.*
- 7) *Review:*
 - *the categorization of some elective courses in favor of their being mandatory regarding the criminal profile in the criminal sciences (especially the subject "Juvenile Criminal Law"). The elective courses should be such that the student can choose among those offered by the program.*
 - *the distribution of credits of some subjects and their qualification as characteristic subjects(B) for the "Lawyer" profile in criminal sciences in favor of their qualification as an interdisciplinary subject.*
- 8) *Aim the organization and participation of the PAE in scientific activities according to the criteria provided by the DCM No. 112/2018, for the promotion of the academic staff.*
- 9) *Encourage and financially support the exchange of academic staff or students of the Program or Faculty of Law, even for a short-term one.*
- 10) *The institution should now refer to a late labor market study as in the internal review report (RVB) it refers to a labor market study made at the time of licensing.*
- 11) *The diploma should be covered by the PAE in the coming academic years so that the PAE's teaching load is in line with the applicable legal regulation.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof.As. Skerdian Kurti

Dr. Rezarta Demneri

Përgjigje e GVJ për Komentët e KUL për Draft RVJ:

Megjithëse në përgjithësi Ekspertët e Jashtëm kanë rënë dakort për përgjigje të njëjta për komentet, në disa raste kanë preferuar të kenë përgjigje *individuale*.

Në këto raste, paragrafi përkatës në RVJ do të referojë në përgjigjen e GVJ, pas komenteve të KUL, ku secili ekspert shpreh qëndrimin e tij mbi çështjen konkrete.

Përgjigjet e Ekspertëve të jashtëm për komentet e bëra nga KUL mbi Draft RVJ, janë *si më poshtë*:

1. Draft Raporti i GVJ (Faqe 4):“Të mbahet një ekuilibër dinamik në çështjen e ndërtimit të punës së personelit akademik mbi kërkimin shkencor të studentëve” është plotësuar **pjesërisht** pasi sipas GVJ-së “Studentët e Institucionit rezultojnë të jenë aktivizuar në punimin e artikujve shkencorë të botuar në Revistën e IAL-së “Mendimi” edhe pse jo detyrimisht gjatë frekuentimit të këtij Programi apo gjatë ndjekjes së studimeve në këtë Institucion. Studentët janë të detyruar të zgjedhin një nga 91 temat e caktuara paraprakisht nga personeli akademik i angazhuar në Program çka përbën kufizim të spektrit kërkimor-shkencor”

Koment KUL: *GVB është e paqartë për konstatimin e bërë nga GVJ se “edhe pse jo detyrimisht gjatë frekuentimit të këtij Programi apo gjatë ndjekjes së studimeve në këtë Institucion”, pasi ky konstatim është i pabazuar dhe i pavërtetë. Të gjithë studentët që kanë botuar në Revistën “Mendimi” kanë qënë studentë në ndjekje të këtij programi ose në fazën përpara diplomimit të tyre.*

Përsa i përket pretendimit se studentët janë të “detyruar” të zgjedhin 91 tema të caktuara paraprakisht nga personeli akademik i angazhuar në Program çka përbën kufizim të spektrit kërkimor-shkencor” GVB e gjen totalisht subjektiv dhe të pabazuar këtë pretendim pasi konsideron se përzgjedhja e një liste të gjërë temash nga trupa akademike drejtuese e këtij programi studimi jo vetëm garanton punime cilësore dhe me vlerë të shtuar në këtë fushë por dhe siguron mos duplikimin e temave nga ana e studentëve (gjë që ndodh rëndomtë në IAL-të të cilat lejojnë pa kriter përzgjedhjet e temave nga vetë studentët, duke stimuluar kështu sjelljen e temave të gatshme dhe punime kryesisht plagjiaturë). Gjithashtu studentët e këtij programi studimi kanë mundësinë dhe të drejtën e zgjedhjes brënda këtij diapazoni të gjerë tematikash, duke propozuar dy ose tre alternative, sipas fushës së interesit dhe kjo padyshim që mundëson të drejtën e zgjedhjes dhe nuk mund të konsiderohet kjo praktikë si kufizimi i spektrit kërkimor-shkencor, sikurse GVJ konstaton në mënyrë aspak objektive.

Nga ana e GVB-së ky konstatim i GVJ-së nuk shihet aspak si kufizim por si një kontroll i rëndësishëm i cilësisë dhe origjinalitetit të punimeve.

Përgjigje e GVJ:GVJ është dakort pjesërisht me komentin KUL, dhe vlerësimi i përmbushjes së Rekomandimit nga “Pjesërisht” bëhet “Kryesisht” por formulimi i paragrafit në RVJ nuk ndryshon.

- a. Njëri prej Ekspertëve shton se “Në lidhje me këtë Rekomandim institucioni ka bërë përpjekje të shumta me qëllim përmirësimin e tij”.
- b. Eksperti tjetër i përgjigjet argumentave në komentin KUL si më poshtë vijon:
 - GVJ pyeti gjatë vizitës përfaqësues të KUL nëse studentët që kishin botuar në Revistën “Mendimi” ishin ndjekës të një Programi studimi gjatë procesit të publikimit për shkak se vuri re në një nga numrat e Revistës paraqitur gjatë vizitës rastin e një autori (student) që kishte shënuar përkrah emrit të tij, si institucion të arsimit të lartë të lidhur me të (i.e. *affiliated institution*), një universitet hollandez, pra jo KUL. **Meqenëse konsultimi i evidencave është random dhe u has rasti i sipërpërmendur, GVJ i qëndron mendimit se studentë të KUL që kanë publikuar punime në Revistën “Mendimi” jo detyrimisht kanë qënë ndjekës të një programi studimi në KUL në kohën kur është botuar artikulli.**
 - Eksperti vlerëson se është kontradiktore komenti KUL se kufizimi i alternativave të temave mbi të cilat studentët mund të punojnë sipas një liste të hartuar paraprakisht nga Departamenti ka qëllim

“shmangien e përsëritjes së temave” përsa në fakt kufizimi i zgjedhjes rrit mundësinë e përsëritjes së temave.

- Sa i përket komentit të mësipërm të KUL mbi mundësinë që studenti “të propozojë 2-3 alternativa” mbi temat e listuara paraprakisht nga DDP, Eksperti vlerëson se një gjë e tillë nuk i është komunikuar gjatë vizitës në Institucion. Nëse realisht është proceduar ndonjëherë në këtë formë, alternativat e propozuara nga studenti do të përbënin në fakt tematika, e rrjedhimisht tema të reja. Ndaj në këtë eventualitet, do të dilej përtej listës së hartuar paraprakisht nga Departamenti që cilësohet në Komentin KUL si mekanizëm i aftë për të shmangur plagjiaturën. Eksperti vlerëson se edhe po të pranohej qëndrimi i GVB se hartimi paraprakisht i listës me temat e diplomës është një mekanizëm për të shmangur plagjiaturën, do të ishte e volitshme që KUL, në kuadrin e balancës mes interesave konkurruese i.e. shmangies së plagjiaturës dhe promovimit të lirisë akademike dhe nxitjes së kërkimit shkencor me një spektër të gjerë, gjithsesi t’i jepte prioritet këtij të fundit përsa plagjiatura mund të shmanget pjesërisht edhe nëpërmjet kujdesit të treguar nga pedagogu udhëheqës apo komisioni vlerësues, duke konsideruar edhe numrin e kufizuar të studentëve.
2. Draft Raporti i GVJ (faqe 4):“E drejta për aksesimin e bibliotekës elektronike Questia (Evidenca 25) ka skaduar që në 2017 dhe disa tekste bazë të lëndëve të zhvilluara në Program nuk gjenden në bibliotekën e Institucionit çka nuk mundëson zhvillimin e kërkimit shkencor nga ana e studentëve apo e stafit akademik me përjashtim të eventualitetit që këta të fundit të angazhohen individualisht dhe në mënyrë autonome për gjetjen e burimeve bibliografike te nevojshme për kërkimin shkencor” është plotësuar pjesërisht

Koment KUL: *GVB e gjen të pavërtetë këtë pretendim, pasi abonimi në bibliotekën elektronike Questia vazhdon të jetë i aksesueshëm në çdo moment (bashkëlidhur këtij observacioni evidence përkatëse lidhur me pagesën e fundit online të abonimit nga Administratori i Institucionit Z. Kino Buxheli, në Nëntor 2018). Kjo bibliotekë online ka në dispozicion të lexuesit mbi 80.000 artikuj dhe punime shkencore. GVB është e paqartë se cilëve lëndë të pambuluara me tekst të detyruar në këtë program studimi i referohet GVJ-së.*

Përgjigje e GVJ: Ekspertët e Jashtëm nuk kanë përgjigje të njëjtë për komentin KUL dhe parashtrojnë si më poshtë vijon:

- a. Njëri prej Ekspertëve vendos që komenti KUL **nuk pranohet** sepse: GVJ ka konstatuar se abonimi në Bibliotekën elektronike “Questia” ka skaduar në 2017 përsa këtë informacion përmbante Evidenca 25 e parashtruar nga GVB. Gjithashtu gjatë vizitës në korrik 2019, GVJ-së iu komunikua se nuk ishte më aktiv aksesi në Bibliotekën Questia. Në konsideratë të e-mailit bashkëlidhur komenteve KUL mbi Draft-RVJ sa i përket abonimit në Questia në emër të Administratorit Z. KB që mban datën 13 nëntor 2018, eksperti vëren se ky abonim me vlerë 99.95 \$/vit është **personal për Administratorin KB dhe jo për KUL si institucion** dhe si i tillë, aksesi nga personat e paautorizuar siç do të ishin studentët/pedagogët, është në shkelje të të drejtave të autorit siç përcaktohet edhe në seksionin “Questia Membership” të faqes zyrtare së bibliotekës <https://www.questia.com/help> konkretisht “Sharing your account with others is a violation of Questia's Subscriber Agreement. This policy is in place not only to protect our copyrighted books, magazines, journals, and newspapers, but also to protect you and your billing information. To that end, Questia monitors for account sharing. Be aware that sharing your account may result in additional charges or the permanent discontinuation of your account”.

Sa i përket komentit të KUL se “GVB është e paqartë se cilëve lëndë të pambuluara me tekst të detyruar në këtë program studimi i referohet GVJ-së”, eksperti sqaron si më poshtë tesktet:

- Fraenkel J. “How to design and evaluate research in education” listuar si literaturë e detyrueshme në syllabus-in e lëndës “Metoda të Kërkimit Shkencor”. Kjo iu vu në vëmendje përfaqësuesve të KUL gjatë vizitës më pedagogët e Programit.

- Gjithashtu, Canaj/Bana “*E drejta e Bashkimit Europian*” në lëndën “Zhvillime aktuale në të drejtën europiane”.
- b. Eksperti tjetërvensos që komenti i KUL **pranohet** pas dokumentit të sjellë në plotësim të tij sepse: “*E drejta për aksesimin e bibliotekës elektronike Questia nuk ka skaduar dhe kjo ndihmon në gjetjen e teksteve të nevojshme për kërkimin shkencor.*”
- 3. Draft Raporti i GVJ (faqe 4): “Të bëhen më shumë përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik efektiv” është plotësuar **pjesërisht** pasi sipas GVJ-së “Përsa i përket personelit akademik të Programit rezulton se: Numri i PAE anëtarë të Departamentit të së Drejtës Penale (DDP) të angazhuar në mësimdhënie në këtë Program në vitin akademik 2018-2019 ka rënë nga 4 në 3 krahasuar me atë të vitit akademik 2013-2014. Përveç 3 PAE të DDP, IAL-ja ka angazhuar në këtë Program edhe 2 pedagogë PAE të strukturave të tjera të IAL-së (përkatësisht nga Departamenti i së Drejtës Publike dhe nga TIK), nga të cilët njëri është ekspert i fushës në të cilën zhvillon mësim. Numri i pedagogëve efektivë të IAL-së të angazhuar në këtë Program është rritur me 1 PAE krahasuar me 4 PAE të vitit akademik 2013-2014 por **numri i PAE të Departamentit të së Drejtës Penale** në fakt është ulur me 1 PAE krahasuar me vitin akademik 2013-2014.”

Koment KUL: *GVB sqaron se komenti i GVJ-së është totalisht i paqartë dhe konfuzë. Rekomandimi i lënë nga Këshilli i Akreditimit ka të bëjë me rritjen e numrit të personelit akademik efektiv në këtë program studimi (pasi ky rekomandim është pjesë e procesit të akreditimit të këtij programi studimi dhe jo akreditimit institucional të institucionit). GVB gjykon se institucioni e ka përmbushur plotësisht këtë rekomandim pasi në total Departamenti i së Drejtës Penale ka në përbërje të saj 7 pedagogë efektiv 3 prej të cilëve me grada shkencore dhe tituj akademik, duke plotësuar kështu të gjitha kërkesat dhe standartet ligjore (shih nenin 25 pika 4 e Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë)*

Ndryshe nga viti 2013-2014 (i marr si referencë nga GVJ, që prej vitit 2016 të tre anëtarët e personelit akademik me grada shkencore dhe tituj akademik të Departamentit të së Drejtës Penale, janë lektor dhe titullar lënde në këtë program studimi.

Përgjigje e GVJ: GVJ pranon *pjesërisht* komentin e KUL dhe ka bërë ndryshim të vlerësimit të plotësimit të Rekomandimit nga “**Pjesërisht**” në “**Kryesisht**”. Përveç kësaj pike, formulimi i paragrafit nuk ndryshon në RVJ përse aty është e sqaruar në detaj se si ka ndryshuar angazhimi i PAE në Program në varësi të faktit nëse janë efektivë ngushtësisht të DDP apo pedagogë efektivë të KUL i.e. edhe të strukturave të tjera të IAL-së që ofron Programin. Mandej, ekspertët e jashtëm i përgjigjen komentit KUL si më poshtë:

- a. Njëri prej Ekspertëve: Komenti i KUL mbi gradën shkencore dhe të qenurit përgjegjës lënde të 3 PAE të DDP në këtë Program nuk është relevant përse i përket objektit të Rekomandimit të Këshillit të Akreditimit të vitit 2013 mbi nevojën që KUL të rrisë numrin e PAE në Programin MSc EDP.
- b. Eksperti tjetër: Nëse rekomandimi është që të rritet numri i PAE që jep mësim në këtë Master, pavarësisht departamentit ku pedagogu bën pjesë, atëherë nxjerr si konkluzion që KUL ka bërë përpjekje për të përmirësuar këtë pikë pavarësisht vështirësive të shumta që ekzistojnë për të realizuar këtë gjë.”
- 4. Draft Raporti i GVJ (faqe 4-5): “Duke konsideruar që numri total i pedagogëve të angazhuar në Program në periudhën nga viti 2013-2014 në 2018-2019 nuk ka ndryshuar i.e. 10 pedagogë, GVJ vëren se raporti PAE/PAK nga viti akademik 2013-2014 ka ndryshuar nga 4/6 në 5/5. Nga ana tjetër, në vitin akademik 2018-2019, 1 PAK nuk ka gradën shkencore “Doktor” në fushën që

zhvillon mësim dhe 1 PAK nuk ka gradën shkencore “Doktor” por gradën profesionale “Mjek” (MD) dhe Specializim Pasuniversitar (SPA) dhe mbi 50 vite eksperiencë akademike e profesionale.”

Koment KUL: *GVB gjykon referuar planit mësimor dhe ngarkesës së stafit akademik (evidence këto bashkëlidhur RVB-së) personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën më të madhe të këtij programi studimi si dhe lëndëve karakterizuese të tij duke i lënë ngarkesë më të vogël personelit akademik më kontratë të cilët përmbushin dhe kriterin e rekomanduar nga Këshilli i Akreditimit në akreditimin e parë të këtij programi studimi (pedagogë të jashtëm duke siguruar në rekrutimet e personelit të pedagogëve kriterin e cilësisë, bazuar në profilin e spikatur, karrierën në fushën përkatëse, përvojën në mësimdhënie dhe punën kërkimore e botuese) ashtu dhe sikurse GVJ ka konstatuar si më sipër.*

Përgjigje e GVJ:

- a. Njëri prej Ekspertëve vendos që komenti KUL **nuk pranohet** dhe formulimi i paragrafit në RVJ **nuk ndryshon** sepse: Mbulimi i lëndëve karakterizuese nga stafi efektiv nuk është standard vlerësues ndërsa sa i përket mbulimit të ngarkesës mësimore GVJ ka analizuar në detaj si është shpërndarë kjo ngarkesë bazuar në evidencat e parashtruara nga KUL. Sa kohë KUL nuk ka sjellë evidenca të tjera, konstatimi i parashtruar në RVJ nuk mund të ndryshojë. Gjithashtu GVJ ka vërejtur që një PAK tejkalonte normën mësimore të lejuar për këtë kategori pedagogu me 75% kështu që komenti i mësipërm i KUL nuk përputhet me realitetin e konstatuar gjatë vizitës dhe me evidencat.

Komenti i KUL gjithashtu nuk merr parasysh konstatimin e mungesës së gradës shkencore “Doktor” të një PAK-titullar lënde apo gradën shkencore “Doktor” në fushën e së drejtës civile të një lektori të punësuar pranë Departamentit të së Drejtës Publike të angazhuar në një program studimi që i përket DDP.

- b. Eksperti tjetër: komenti KUL **pranohet pjesërisht** përse KUL ka bërë përpjekje për përmirësimin e këtij rekomandimi por mbi bazën e të dhënave që na janë vënë në dispozicion shohim se ky raport nuk ka patur përmirësime të ndjeshme edhe pse janë bërë përpjekje për rekrutimin e personelit akademik të brendshëm.

5. Draft Raporti i GVJ (faqe 9): Emërtimi i njësisë bazë duhet të rishikohet në formatin E drejtë Civile, Publike/ Penale

Koment KUL: *GVB gjykon se GVJ ka dal jashtë kompetencave të saj pasi emërtimi ekzistent i njësisë bazë të Fakultetit të Drejtësisë së KU “Luarasi” ka kaluar me sukses filtrin e miratimit të Statutit të Institucionit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Akreditimin Institucional të zhvilluar nga ASCAL dhe QAA, duke u akredituar për plot 6 vite.*

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL pranohet pjesërisht. Përderisa “Struktura akademike e Fakultetit/ Departamentit të së Drejtës Penale” është një nga treguesit e matshëm për vlerësimin e Programit MSc_EDP GVJ ka të drejtë të shprehet në formë rekomandimi/sygjërimi mbi aspekte të organeve që ofrojnë programin e studimit, përfshirë edhe emërtimin. Nga ana tjetër, GVJ pranon si të saktë emërtimin e njësisë bazë në “Departament të së Drejtës Private” përse e drejta private përfshin përveç së drejtës civile edhe aspekte të marrëdhënies mes personit dhe shtetit kur ky i fundit nuk vepron në ushtrim të pushtetit të tij urdhërues. Përse më sipër, komenti në RVJ (f. 9) mbi emërtesën e “Departamentit të së Drejtës Private” do fshihet.

6. Draft Raporti i GVJ (faqe 11): Në disa raste PAK janë edhe titullar lënde të pambështetur nga ndonjë PAE.

Koment KUL: GVB e gjen këtë konstatim të pabazuar në ligj apo standartet e arsimit të lartë. Për aq kohë sa PAK si titullar lëndë plotëson të gjitha kriteret ligjore, mbështetja nga PAE nuk është kërkesë e bazuar në ligj dhe as domosdoshmëri. (Nga konstatimi jonë bëhet fjalë vetëm për dy PAK)

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL nuk pranohet dhe GVJ i qëndron konstatimeve në RVJ në këtë pikë, me arsyetimin: Të qenurit titullarë lëndë e PAK është një fakt i konstatuar, nuk ka pse të bazohet në ligj. GVJ nuk e ka raportuar këtë fakt si shkelje të ligjit por thjesht e ka konstatuar. KUL komenton që “Për aq kohë sa PAK si titullar lëndë plotëson të gjitha kriteret ligjore...”; mbi këtë pikë GVJ risjell në vëmendje se ka konstatuar që 1 PAK-titullar lëndë nuk ka gradën shkencore “Doktor” dhe kjo është në shkelje të standardeve të cilave KUL i referohet në koment.

Janë 3 PAK titullarë të lëndëve të pambështetur nga një PAE në 4 lëndë në total, konkretisht Xh.Z, N.Sh dhe Xh.Sh. jo dy siç komenton KUL. Gjithashtu, përpos këtyre tre PAK, 1 PAE-titullar lëndë i përket një Departamenti të ndryshëm nga DDP.

7. Draft Raporti i GVJ (Faqe 12): “Raporti PAE/PAK i ngarkesës mësimore në auditor është 60%:40%”

Koment KUL: GVB gjykon se pretendimi është i pabazuar, kjo pasi se nga viti akademik 2013-2014 deri me hyrjen në fuqi të Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademi në institucionet e arsimit të lartë” IAL është bazuar në Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë” i cili parashikonte si ngarkesë mësimore Udhëheqjen e Praktikës Mësimore dhe Temave të Diplomës. Plani mësimor i paraqitur si evidencë tek i cili referohet dhe ky konstatim i GVJ-së i përket viteve akademike 2017-2019 (shpërndarja e ngarkesës është bërë siaps Udhëzimit Nr. 20) Edhe Udhëzimi i ri (nr. 29) parashikon këto veprimtari si ngarkesë mësimore por jashtë auditorit. Nëse i referohemi Standardit III.1, Kriterit 2 i cili shprehimisht thotë se “Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve” ky standard nuk i referohet specifikisht orëve brenda auditorit. Pra në interpretimin tonë përfshinë të gjithë veprimtarinë mësimore në funksion të programit.

Përgjigje e GVJ:GVJ pranon pjesërisht komentin e KUL, dhe arsyeton se:GVJ ka raportuar mbi 2 raporte PAE/PAK me qëllim për të dhënë një informacion të detajuar të shpërndarjes së ngarkesës mësimore.

Për informacion, është konstatuar raporti 60%:40% PAE/PAK sa i përket ngarkesës mësimore brenda auditorit, kurse sa i përket ngarkesës mësimore në total (brenda dhe jashtë auditorit) raportuar në f. 14 të Draft RVJ, GVJ arsyetoi se “nëse PAE-të mbulojnë tërësisht ngarkesën e parashikuar për diplomën/provimin përfundimtar atëherë përmbushin kriterin që së paku 70% e ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit të jetë e mbuluar nga PAE. Nëse u caktohet ngarkesë për diplomën/provimin përfundimtar pedagogëve PAK siç rezulton nga Tab. 15, atëherë ky kriter nuk përmbushet” referuar viteve të ardhshme, jo këtij rrjedhës kur ka patur ndryshim të rregullimit ligjor. Në këtë pikë, GVJ konfirmon qëndrimin e saj mbajtur në Draft RVJ por do të saktësojë në RVJ që nevoja që diploma të mbulohet nga PAE i referohet vitit të ardhshëm akademik.

8. Draft Raporti i GVJ (Faqe 13): “Institucioni nuk ka përmbushur detyrimin për përfaqësim të barabartë gjinor me jo më pak se 30% për secilën gjini në një institucion sipas sa përcaktuar nga Ligji nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Koment KUL: Përsa më sipër GVB i bën me dije GVJ-së se Departamenti i së Drejtës Penale është vetëm një nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Drejtësisë i cili është vetëm një nga tre Fakultetet në përbërje të KU

“Luarasi.” Cka do të thotë që konkluzioni i GVJ-së është i pasaktë, i pabazuar dhe tendencioz. KU “Luarasi” është një institucion që respekton barazinë gjinore duke vlerësuar në rradhë të parë kriterin e cilësisë, arritjeve akademike dhe profesionalizmit.

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL pranohet dhe RVJ do të ndryshojë. Do të hiqet si vërejtje në RVJ dhe do të saktësohet për informacion se përfaqësimi gjinor me jo më pak se 30% për secilën gjini nuk është respektuar në nivel njësie bazë në Departamentin Penal por se në nivel njësie kryesore (FD), ky raport është respektuar në masën 62%:38%.

9. Draft Raporti i GVJ (Faqe 17): KUL nuk përcolli CV-në e një PAK paçka se ia parashtrroi në vizitë e GVJ-së që kërkoi ta verifikonte.

Koment KUL: GVB sqaron së dosja e kërkuar nga GVJ e PAK i është vënë në dispozicion GVJ-së gjatë vizitës në institucion. Si dhe kjo kërkesë nuk rezultoi e bërë si dokument shtesë tek koordinatori i institucionit (ashtu sikurse është proceduar për të gjitha dokumentat shtesë të kërkuara). Megjithatë GVB e bashkëlidh CV dhe Gradën Shkencore të PAK këtij observacioni.

Përgjigje e GVJ: Komenti KUL nuk pranohet si argumentim sepse CV-të e pedagogëve PAE/PAK përcillen si pjesë e dokumentacionit të IAL-së aplikante për akreditim ndaj nuk është e nevojshme të kërkohen gjatë ose pas vizitës. GVJ e kërkoi gjatë vizitës CV-në e PAK gjatë takimit me Zyrën e Burimeve Njerëzore përse nuk ndodhej në dokumentacionin elektronik (Anekset) dhe as në dosjet personale të pedagogëve të angazhuar në MSc_EDP të vëna në dispozicion nga Zyra e Burimeve Njerëzore. **Gjithsesi, RVJ do të ndryshojë** duke e fshirë konstatimin mbi mungesën e CV-së së RZ meqenëse KUL e integroi këtë të fundit më 30 shtator.

10. Draft Raporti i GVJ (Faqe 28): “Përse i përket kategorive të veprimtarisë formuese dhe raportit mes këtyre ishte zgjedhur të respektohej Udhëzimi i MASH nr. 15/2008 dhe jo VKM n. 41/2018 e cila parashikon 5 kategori veprimtarish formuese (A-F) përkundrejt 6 të Udhëzimit të MASH n.15/2008 (A-E)”

Koment KUL: GVB i bën me dije GVJ-së se Udhëzimi i MASH nr. 15/2008 përmban 6 kategori veprimtari formuese (A-dhe jo nga (A-E) sic GVJ është shprehur (ndarje që i përket VKM nr. 41). Si dhe gjithashtu sqaron se periudha të cilës i referohet GVJ (shih Evidencen nr. 39 të RVB-së – Plani Mësimor 2017-2019) e cila përkon dhe me periudhën 6 vjecare të akreditimit (2013-2019) i nënshtrohet rregullimeve të bëra nga Udhëzimi i MASH nr. 15/2008. Pra GVB sqaron që respektimi i këtij Udhëzimi nuk është dëshirë e institucionit por respektim i ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ky plan mësimor i paraqitur dhe si evidencë i ka filluar efektet e tij juridike në vitin 2017 e i vazhdon deri në përfundim të tij. Pretendimi i GVJ-së është i pabazuar në ligj.

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL pranohet pjesërisht. Në RVJ është përcjellë se KUL ka përzgjedhur të zbatojë Udhëzimin MASH n. 15/2008 sa i përket elementëve të programit të studimit pasi kjo u diskutua edhe gjatë vizitës. GVJ rekomandon që Udhëzimi MASH n. 15/2008 të jetë i zbatueshëm vetëm për Programet që janë në zhvillim e sipër gjatë kohës që ka ndryshuar rregullimi ligjor i.e. për vitin akademik 2017-2019. **GVJ ka sygjerruar në RVJ që KUL të marrë përsipër të konformohet me rregullimin e VKM n. 41/2018 i cili parashikon 5 kategori veprimtarish formuese (A-E) por do të saktësohet në të se ky sygjerrim nuk i referohet Programit që është në zhvillim e sipër por atyre të viteve të ardhshme.**

11. Draft Raporti i GVJ (Faqe 30): Studentëve duhet t’u jepet mundësia që realisht të zgjedhin lëndën që preferojnë, jo të ndjekin një lëndë që de facto kthehet në e detyrueshme

Koment KUL: GVB konstaton se ky pretendim është thjeshtë një opinion subjektiv i GVJ-së i pabazuar në fakte dhe i pavërtetë. Studenti ka lirinë të zgjedh një nga lëndët me zgjedhje të ofruara për këtë program studimi. Këtë proces ai e kryen në fillim të çdo semestri duke plotësuar një formular në sekretarinë mësimore me lëndën e zgjedhur. Nëse GVJ do të kishte dyshime apo do ishte interesuar për këtë procedurë gjatë vizitës në KUL, do të kishte konstatuar që gjatë viteve të ndryshme akademike lëndët me zgjedhje të studentëve kanë qënë të ndryshme. Ky konstatim bëhej lehtësisht në sekretarinë mësimore duke verifikuar regjistrin e notave të studentëve.

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL pranohet pjesërisht dhe paragrafi në RVJ do të ndryshojë si më poshtë “Studentëve duhet t’u jepet mundësia që të zgjedhin lëndën që preferojnë nëse plotësohet numri minimal i kërkuar për aktivizimin e kësaj të fundit. Në të kundërt, lënda me zgjedhje nuk do të ishte më e tillë por e detyrueshme. Nga ana e institucionit duhet të bëhet një punë më e madhe me qëllim që studentët që kanë zgjedhur këtë program studimi të njihen më mirë me lëndët me zgjedhje që ky program ofron, përpara se të vendosin se çfarë lënde do të zgjedhin.

12. **Draft Raporti i GVJ (Faqe 31-32 dhe 34):** Kriminalistika është cilësuar si e detyrueshme dhe ka më shumë kredite se çdo lëndë tjetër (10 ECTS) dhe është cilësuar si lëndë karakterizuese (Kategoria B) për këtë Program ndërkohë që është lëndë integruese/ndërdisciplinore dhe në programe të ciklit të dytë rezulton zakonisht si lëndë me zgjedhje (D) ose si lëndë integruese/ndërdisciplinore. Është cilësuar si lëndë me zgjedhje por në fakt nuk aktivizohet, lënda “E drejtë penale për të miturit” që do të përbënte lëndë karakterizuese për këtë program dhe ka relevancë dhe mund të ishte përfshirë si lëndë e detyrueshme. Lënda “Metodat e kërkimit në shkencat juridike” është cilësuar si lëndë karakterizuese (B) për këtë Program. Në dritën e procedurës se si përzgjidhet nga ana e studentëve tema e diplomës nga lista me alternativa e paracaktuar nga pedagogët e Programit dhe dijenisë për pamundësinë e aksesit në biblioteka elektronike (abonimi në Questia ka skaduar në vitin 2017) kjo lëndë do të ishte e cilësueshme si lëndë e formimit të përgjithshëm ose lëndë ndërdisciplinore/integruese. Ky program i pajis studentët me njohuri teorike dhe kryesisht praktike të metodave të hetimit penal për ata që synojnë të zhvillojnë studimet e ciklit të tretë. Diplomantët e këtij masteri fitojnë diplomën Master i shkencave në “E drejtë Penale”.

Koment KUL: Lidhur me procedurën e përzgjedhjes së temave të diplomës nga ana e studentëve dhe aksesin në bibliotekën elektronike Questia, lutem shihni sqarimin e mësipërm për këtë çështje. Gjithashtu për sa i takon kategorizimit të lëndës që ju i referoheni në këtë konstatim, jeni sqaruar me lart, duke shpjeguar se gjithçka është realizuar bazuar në aktet liigjore dhe nënligjore në fuqi për periudhën kur ky program po riakreditohet.

Përgjigje e GVJ: Sa i përket pjesës së Komentit KUL mbi Bibliotekën Questia dhe listën e temave të diplomës të studentëve, shih komentet e Ekspertëve të Jashtëm më lart.

Pjesa tjetër e paragrafit përkatës në RVJ komentuar nga KUL nuk ndryshohet por sqarohet se

- a. Njëri prej Ekspertëve: kategorizimi i lëndës “Kriminalistika” dhe “Metodat e Kërkimit në Shkencat juridike” si lëndë karakterizuese nuk lidhet me aktin nënligjor të zbatueshëm siç komenton KUL përsa si Udhëzimi MASH i 2008 ashtu edhe VKM nr. 41/2018 nuk kanë ndryshim mes tyre sa i përket cilësive që duhet të ketë lënda për t’u kategorizuar si “karakterizuese”. Nga ana tjetër, “Metodat e kërkimit shkencor” janë të kategorizueshme ose si lëndë bazë ose si lëndë ndërdisciplinore. Gjithashtu, *Kriminalistika* nuk është lëndë karakterizuese për profilin jurist në të drejtë penale dhe kjo lëndë nuk është degë e së drejtës siç përcaktohet në syllabus. Siç është raportuar në RVJ, *Kriminalistika* mund të ishte lëndë karakterizuese në Masterin Profesional “Siguria dhe Rendi Publik” ofruar po nga KUL. *Kriminalistika* i referohet shkencave të zbatuara përgjatë procesit të zbulimit të krimeve dhe mbledhjes së provave sipas standardeve që të jenë të pranueshme në një proces gjyqësor.

- b. Eksperti tjetër:sa raportuar në RVJ mbi kategorizimin e lëndëve të Programit kanë natyrë rekomanduese dhe KUL nuk ka kryer shkelje në këtë pikë pasi çdo institucion e zgjedh vetë mënyrën e ndërtimit të programit për të cilën mund të ketë edhe kosto në të ardhmen.

13. Draft Raporti i GVJ (Faqe 34): Programi është në përputhje me nevojat e tregut ndaj GVJ rekomandon IAL-në të kryej një studim të mirëfilltë dhe aktual tregu të punës meqenëse në RVB i referohet një studimi të ndërmarrë para licensimit.

Koment KUL: GVB sqaron se *Programi i studimit "Master i Shkencave" në "E drejtë Penale" është çelur që prej vitit 2009 dhe është një vazhdim organik i programit të studimit "Bachelor" në "Drejtësi", në përfundim të të cilit studenti profilizohet në një nga fushat kryesore të së drejtës (kujtojmë GVJ--në që tre profilet bazike të së drejtës janë fusha civile, penale dhe publike). Ky program studimi i profilizuar në këtë fushë është i njëjtë në të gjitha IAL-të që ofrojnë programin e studimit "Bachelor" në "Drejtësi". GVB ka bashkëlidhur RVB-së një dokument mbi studimin e tregut i cili ka shërbyer në fazën e licensimit të programit. Në vazhdimësi ky program studimi është testuar nga kërkesat e studentëve për këtë program studimi por edhe nga gjurmimi i Alumneve të cilët janë profilizuar dhe punësuar në këtë fushë.*

Përgjigje e GVJ:Komenti i KUL nuk pranohet dhe GVJ i qëndron konstatimeve në RVJ në këtë pikë, me arsyetimin: Përditësimi i informacionit nëpërmjet studimeve të posaçme sa i përket nevojave të tregut nuk është asgjë tjetër veçse diçka pozitive dhe GVJ ka shprehur veçse një rekomandim që KUL mund ta marrë ose jo në konsideratë.

14. Draft Raporti i GVJ (Faqe 41): Gjatë vizitës, GVJ u informua se ekziston një fond për kërkimin shkencor në nivel Fakulteti për të cilin personeli akademik që mund të aplikonte për mbështetje nuk kishte në fakt informacione të sakta. Institucioni vlerësonte që dhënia e lejes pedagogut që kërkon të zhvillojë një aktivitet kërkimor-shkencor jashtë vendit (për periudha të shkurtra disa-ditore) dhe mosndërprerja e pagës gjatë kësaj periudhe përbënte mbështetje financiare. Nga ana tjetër, GVJ vëren se Ligji nr. 80/2015 dhe aktet e Institucionit përcaktojnë se avancimi në karrierën profesionale dhe prodhimi i output-eve shkencore është detyrim i personelit akademik po ashtu siç është detyrim për IAL-në të stimulojë kërkimin shkencor tek stafi i saj efektiv. GVJ vlerëson që dhënia e lejes për të kryer kërkim shkencor jashtë vendit apo mosprerja e pagës nuk mund të cilësohet mbështetje e aq më pak stimulim kur kjo shkëputje është detyrim i IAL-së ndaj pedagogut që ka punësuar nga i cili pretendon të rritet profesionalisht. Gjatë vizitës, GVJ-ja u vu në dijeni nga përfaqësues të stafit akademik efektiv se mbështetje financiare për kërkim shkencor konsiderohej të ishte edhe mospagesa e fee-së për të marrë pjesë në konferencat shkencore të organizuara nga Institucionid he se në mënyrë të përciptë kishin informacion se 2 kolegë nga strukturat e tjera të Institucionit ishin angazhuar në veprimtari kërkimore-shkencore në kuadrin e FAB në Bolonja dhe Zagreb (Shih Aneks Tab. 22, pika 6). Fakti që informacioni i disponuar nga stafi akademik efektiv i Programit ishte i përciptë tregon se objektivi strategjik për një shpërndarje të tregullt të informacionit mbi mbështetjen institucionale për aktivitetin akademik dhe kërkimin shkencor tek studentët dhe pedagogët nuk është realizuar (shih Evidencën n. 2, Plani Strategjik për 2016-2020, f. 15-16). Përsa më sipër, GVJ vlerëson si të vështirë që IAL-ja të ketë realizuar objektivin e rritjes së fondeve për zhvillimin profesional të personelit akademik kur ky i fundit nuk është në dijeni që ka fond për kërkimin. Institucioni ka përcjellë Evidencën 51 "Strategjia e kërkimit shkencor të Kolegjit Universitar "Luarasi" 2018-2019" që në realitet konsiston në njëplan të kërkimit shkencor në kuptimin e punës shkencore që pritet nga stafi akademik në vend të njëstrategjie të mirëfilltë çka iu vu në vëmendje nga GVJ gjatë vizitës.

Koment KUL: Mbështetja financiare për aktivitetin kërkimor shkencor është e parashikuar që në fillim të vitit akademik kur miratohet në Senat Akademik, Buxheti i vitit akademik dhe ky informacion është i aksesueshem për gjithë anëtarët e personelit akademik, të cilët informohen në mënyrë periodike për çdo vendimarrje të Senatit Akademik.

Konstatimi i GVJ se IAL nuk ka realizuar objektivin e rritjes së fondeve për zhvillim profesional të personelit akademik nuk është i saktë pasi nga viti në vit ky fond ka ardhur duke u shtuar në vlerë monetare (fakt i cili lehtësisht mund të provohet nëse do të krahasoheshin buxhetet financiare vit pas viti) dhe është përdorur për përmbushjen e aktiviteteve me objekt kërkimin shkencor, jo vetëm si Institucion por edhe në mënyrë individuale nga personeli akademik, si mbështetje financiare.

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL pranohet pjesërisht dhe fjalia “Përsa më sipër, GVJ vlerëson si të vështirë që IAL-ja të ketë realizuar objektivin e rritjes së fondeve për zhvillimin profesional të personelit akademik kur ky i fundit nuk është në dijeni që ka fond për kërkimin” do të zëvendësohet me “GVJ ka konstatuar që stafi akademik i Programit derimë tani nuk ka përfituar asnjëherë nga fondi për zhvillim profesional të parashikuar nga KUL” me arsyetimin se: GVJ vërejt gjatë vizitës dhe bisedave me përfaqësues të stafit akademik efektiv të MSc_EDP se në praktikë stafi akademik kishte njohuri të përcipta mbi mundësitë e përfitimit të kontributeve financiare për t’u zhvilluar profesionalisht. 2 pedagogë të KUL për të cilët një përfaqësues i DDP gjatë vizitës kishte dijeni se kishin përfituar mbulim financiar për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare të mbajtura jashtë Shqipërisë, i përkisnin strukturave të tjera të KUL. Meqenëse GVJ konstatoi një mungesë informacioni mes anëtarëve të stafit akademik mbi këto mundësi trajnimi/shkëmbimi/edukimi, në RVJ do shtohet rekomandimi se KUL duhet të bëjë më shumë përpjekje me qëllimin e rritjes së fondeve për zhvillimin profesional të personelit akademik.

15. Draft Raporti i GVJ (Faqe 44): Puna shkencore mungon si deklaram në CV e disa pedagogëve. Asnjë pedagog nuk ka botuar në revista të rankuara nga Thomson Reuters/Scopus sipas VKM n.112/2018)

Koment KUL: GVB sqaron se kjo VKM e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2018, i referohet përcaktimit të kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”

GVJ mund ti referohet kësaj VKM-je në vijim si praktikë e mirë dhe jo si një detyrim për stafin akademik të këtij programi studimi i cili i zotëron tashmë gradat dhe titujt e kërkuar. GVB gjithashtu sqaron se deklarimi i punimeve shkencore në CV respektive është një e drejtë dhe jo një element i detyruar i CV-së. Stafi akademik PAE dhe PAK i këtij programi studimi është i përbërë nga profesorë të nderuar dhe profesionistë të mirëfillt të kësaj fushe, të cilët kanë kontributë të konsiderueshëm akademik dhe shkencor. Një paragjykim i tillë nga GVJ është jo etik dhe jo profesional. GVB gjykon se personeli akademik i cili kontribuon në këtë program studimi është serioz dhe elitar në fushën e së drejtës penale.

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL nuk pranohet dhe GVJ i qëndron konstatimeve në RVJ në këtë pikë dhe shton rekomandimin që stafi akademik të përditësojë CV-të me punën shkencore me arsyetimin: GVJ ka raportuar që CV-të e disa pedagogëve nuk përmbanin listën e botimeve ose kjo listë nuk ishte përditësuar çka iu vu në dukje KUL edhe gjatë vizitës. Edhe po t’i referohemi vetëm Aneks-Tab. n. 23, 1 PAK dhe 1 PAE nuk kanë deklaruar punën shkencore kurse 1 PAK nuk ka punë shkencore për vitet 2013-2018. Për shkak të natyrës së profesionit akademik, lista e publikimeve është pjesë integrale e CV-së së një pedagogu përsa edhe vetë IAL-ja vlerëson performancën e stafit akademik që ka të punësuar bazuar edhe mbi output-in shkencor vjetor.

Siç e përcakton Ligji n. 80/2015 dhe aktet në zbatim si edhe Statuti i KUL dhe kontrata-tip që lidhet mes KUL dhe pedagogut, anëtarët e stafit akademik duhet të punojnë për promovimin profesional individual dhe IAL-ja duhet të përkrahë promovimin e pedagogut përfshirë këtu edhe nëpërmjet suportit më mjete financiare.

Promovimi profesional akademik ka si objektiv ofrimin e një arsimit cilësor dhe të specializuar. Fakti që një pedagog ka marrë gradë shkencore apo titull akademik nuk implikon kurrsesi stanjacion në kërkimin shkencor apo në mësimdhënie pasi e ka fituar këtë titull/gradë sepse secili pedagog ka detyrimin që të përditësojë dhe të zgjerojë dijet duke publikuar punime dhe duke u angazhuar në shkëmbime akademike jashtë vendit.

Një konferencë që të cilësohet shkencore duhet të përmbushë disa kritere dhe kjo nuk rregullohet nga VKM "Për titujt e gradat". GVJ ka raportuar mbi bazën e evidencave të paraqitura nga KUL mbi punën shkencore të stafit akademik efektiv dhe i ka kategorizuar sipas llojit i.e. artikuj (shkencorë ose jo), konferenca kombëtare ose ndërkombëtare, simpoziume etj dhe **nuk është shprehur mbi vlefshmërinë shkencore të këtyre punimeve e aq më pak mbi reputacionin apo "nderin" e stafit akademik të KUL.**

GVJ nuk është shprehur mbi kriteret e VKM "Për titujt e gradat" si një detyrim për t'u përmbushur por ka raportuar nëse punimet e stafit të KUL përmbushin këto kritere. Në RVJ është specifikuar që disa punimeve i.e. artikuj dhe prezantime konference u mungonte cilësimi nëse ishin botuar në *book of proceedings* apo në revista të miratuara nga MASR (MASH) apo nëse u janë nënshtruar *peer-review* kur ishin botuar jashtë Shqipërisë. Edhe referuar kritereve të përcaktuara nga VKM pararendëse n. 467/2007 (e ndryshuar) puna kërkimore-shkencore e stafit akademik efektiv të KUL për periudhën nga viti 2013 është shumë e kufizuar në numër por GVJ gjithsesi ka evidentuar në RVJ përkrah punimeve shkencore edhe kohëzgjatjen e punësimit të pedagogut pranë KUL për të qenë sa më e ekuilibruar në raportim.

Njëri prej Ekspertëve shton se sa parashtruar në paragrafin në fjalë të RVJ është një konstatim që nuk ul vlerën e stafit akademik të KUL.

16. Draft Raporti i GVJ (Faqe 46): Institucioni ka lidhur marrëveshje kuadër me një IAL italiane dhe është në pritje të lidhë 2 të tjera në kuadrin e shkëmbimit të stafit pedagogjik dhe studentëve por nuk ka prodhuar ndonjë raport mbi benefitet nga këto marrëveshje;

Të implementohen marrëveshjet kuadër që ka nënshkruar me IAL-të e huaja ndër vite me objekt mobilitetin e studentëve dhe atë të stafit akademik.

Koment KUL: Lidhur me këtë konstatim të GVJ, GVB sqaron se nje raport mbi përfitimet e marrëveshjeve të nënshkruara, do të mund të prodhohet kur të kemi realizuar objektivat dhe të kemi efektet që do të prodhohen nga vënia në zbatim e marreveshjeve, të cilat do të analizohen për të konkluduar nëse i kemi arritur objektivat dhe pritshmëritë që kishim në momentin fillestar të nënshkrimit të marrëveshjeve.

Përgjigje e GVJ: Komenti i KUL **nuk pranohet** dhe GVJ i qëndron konstatimeve në RVJ në këtë pikëpërpara kanë qëllim të sqarojnë që edhe pse KUL ka marrëveshje me institucione të huaja këto nuk janë implementuar dhe rrjedhimisht nuk ka të dhëna mbi benefitet nga këto marrëveshje.